

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7817 E hënë 11 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**Nga PËLLUMB KARAMETA**

**Pedagogjia narrative dhe formimi shkencor - nga historia te fakti**

Që prej fillimeve, nxënia e shkencës në shkollë ka pasur dy synime kontraktore. Në një anë, përgatitjen e shkencëtarëve të ardhshëm; në anën tjetër, kuptimin bazik...  
Vijon në faqen 21



**Opinion** **Ditës**

**Nga DR. KLODIAN MUÇO**

**10 mëkatet kapitale të ekonomisë shqiptare**

Një ndër problemet kryesore të ekonomisë shqiptare përgjatë 28 viteve të fundit është mungesa e ritmit të njëjtë ndërmjet rritjes ekonomike dhe mirqënies në ...  
Vijon në faqen 20



**INTERVISTA**


## Deputetja e PS: 2 skenarët si ecet më tej **Kumbaro: Deputetët zëvendësues PD-LSI? S'mund të shtiremi si një situatë normale**

Ish-ministria: Opozita, atentat ndaj demokracisë. Ndryshimet në qeveri, miopi po të mos reagohej  
Atentat ndaj demokracisë. Kështu e konsideron ish-ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro vendimin e opozitës për të djegur mandatet duke kërkuar largimin e një qeverie legjitime. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" Kumbaro teksta komenton situatën politike në vend, shprehët se sjella e opozitës përveçse po...  
Në faqet 4-5

## EMRAT/ DOSJET QE IU ESHTË NJOHUR FATURA FINANCIARE NE VITET '93-2013

# ISH-PRONARET, SI PERFITOHET KOMPENSIMI I PERSHPEJTUAR

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin për pagesat. Formula, nëse kërkoni të merrni paratë brenda vitit, ju mbahet 80% e vlerës së kompensimit



(Në foto) Foto ilustruese. Faksimile e formularit që duhet plotësuar

**SPECIALE**

**Ferdinand Samarxhi: Histori e paharruar, 96 vjet Kongres Mysliman Shqiptar**

Në faqet 18-19

**"LIFE PAGES"**

**Altin Çekodhima: Pasojat e polipeve në tëmth dhe rreziku që paraqet moskurimi**

Në faqen 14

**TARIFA E PAKTHYESHME**

**Provim shteti për mësuesit, zbardhen datat e testimit nga Qendra e Arsimit**

Në faqen 11

**MJEKU POPULLOR**

**Ylli Merja: Problemi me tiroidet dhe trajtimi me bimë për rënien e flokëve**

Në faqen 5

**UDHEZIMI**

**ISSH: Kushtet për të përfituar pension familjar, dokumentet që duhen**

Në faqen 10

## Opozita/ Kreu i PD, porosi për forumet: Reagim më i madh se ai i 16 shkurtit **Basha në kryesi: Plani për protestën e 16 marsit**

**Kryemadhi në Krujë: Ta kthejmë Shqipërinë në shtëpinë e shqiptarëve**

Gati 1 javë nga mbajtja e protestës së radhës, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka mbledhur kryesinë e re me të cilën ka ndarë porositë organizative në mënyrë që të garantohet një pjesëmarrje sa më e lartë në 16 mars. Mbledhja ka zatur rreth 1 orë dhe burime pranë saj kanë bërë me dije se kryepozitari ka theksuar se është e domosdoshme që protesta e ardhshme të kalojë atë të 16 shkurtit, si për nga pjesëmarrja ashtu edhe për nga mesazhet që duhet të përcjellë qeverisë dhe opinionit publik...  
Në faqen 3



## KRIZA POLITIKE PROTESTA

### Rama: Roskoveci si Toskana për agroturizëm, duhet vetëm promovim

Gjatë qëndrimit në Qarkun e Fierit, kryeministri Edi Rama u ndal edhe në Kurjan të Roskovecit ku inspektoi punimet që po bëhen për rikonstruksionin e një kisha biznatinte. I shoqëruar edhe nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ministria e Kulturës, Elva Margariti dhe kryetari i Bashkisë së Fierit, ai pa nga afër punën që po bëhet për restaurimin e kësaj kisha dhe kthimin e saj në një tjetër pikë atraktive për vizitorët dhe turistët. Ndërsa ka mbërritur në krye të kodrës ku gjendej kisha, Rama është entuziazmuar nga bukuria dhe peizazhi i zonës përreth, ndërsa nuk ka nguruar ata cilësorë atë



si "Toskana" e Shqipërisë. "Armando s'bëhet agroturizmi këtu? Kjo është Toskanë mo si nuk bëhet agroturizmi këtu. Kjo ka vetëm pak nevojë për promovim", - tha Rama, ndërsa u bëri thirrje të gjithëve të shkojnë në Roskovec. Gjithashtu, vizitoi edhe impiantin e përpunimeve të mbetjeve në Fier, i

cili pritet të përfundohet brenda vitit 2019. Kryeministri Rama u shpreh se banorët e kësaj zone do të shpëtojnë gangrenë mjedisore si pasojë e pirgjeve të plehrave që mblihen dhe digjen pa kriter, ndërsa theksoi se një projekt i tillë pritet të përfshijë edhe Durrësin. "Ky është kalimi nga mesjeta në

kohët moderne në aspektin e trajtimit të mbetjeve. Një projekt i tillë kthehet në një tabelë qitjeje e fut e bjer kush të mundet: "korrupsion", "grabitje", "hajdutëri", "PPP", por lum kush duron dhe koha i vë gjërat në vend. Këtu faktikisht hapet perspektiva për të gjitha bashkitë që t'i sjellin këtu mbeturinat dhe të shpëtojë njëherë e mirë edhe mjedisi në të gjithë qarkun nga hedhjet kuturore të mbeturinave, nga vendgrumbullimet kuturore, nga helmimi i ujërave nga helmimi i tokës, nga helmimi i ajrit, nga dëmtimi i shëndetit. Ne duam të bëjmë të njëjtën gjë edhe për Durrësin," u shpreh Kryeministri.



Berisha denoncoi përpjekjen e qeverisë për të ndërtuar një TEC në afërsi të Korçës

# Filo përplasat me Klosin : Mos aprovo lejen mjedisore për TEC

*Klosi: S'ka asnjë autorizim e asnjë leje jo e jo*

Ish-kryeministri Sali Berisha ka denoncuar djeg një rrezik potencial që mund të dëmtonte gjithë bukurinë dhe ambientin e Korçës. Njëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ai ka bërë të ditur se qeveria ka përgatitur një projekt për ndërtimin e një TEC-i të ri në afërsi të Korçës, çka mund të bëjë shkak për ndotjen e një prej qyteteve më të frekuentuara nga vizitorët dhe pushuesit e tjerë. "Fillimi i punimeve për ndërtimin e një termocentrali prej 500 megavatesh në Korçë, projekt fund e krye mafioz shkatërrimtar për mjedisin, shëndetin e qytetarëve, turizmin dhe prohimin bujqësor të Korçës ka tronditur thellë qytetarët e saj", - shkroi Berisha duke denoncuar këtë projekt. Kaq ka mjaftuar që pushteti vendor dhe qeveria të përfshihen në një debat të gjatë, lidhur me nevojën e këtij TEC-i. I pari që ka reaguar pas këtij denoncimi ka qenë kryebashkiaku i Korçës, Sotiraq Filo, i



Kryebashkiaku i Korçës, Sotiraq Filo

cili nëpërmjet një letre drejtuar ministrit të Mjedisit, Blendi Klosi dhe ministres së MEI, Belinda Balluku, ka shprehur kundërshtinë e tij për ndërtimin e TEC-it. "Ju kërkoi të mos aprovi vlerësimin e ndikimit në mjedis pasi investitorët nuk kanë paraqitur asnjë garanci për një bilanc pozitiv të ndotjes. Projekti është shumë afër qytetit dhe në toka të frytshme bujqësore. Qëndrimi kundër i Bashkisë së Korçës

ka qenë i qartë dhe konsistent që në raportin e përgatitur për KIS në dt. 5.12.2017 ku Bashkia Korçë është shprehur JO me arsyetimin e afërsisë me qytetin. Në këto kushte, ju kërkoi mosaprovimin e këtij investimi, i cili në çdo rast nuk do të mund të realizohet dot në kundërshtim me vullnetin e Bashkisë së Korçës", - thuhet në letrën e kryebashkiakut Filo. Menjëherë pas kësaj ka ardhur reagimi i ministrit të

Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi, i cili nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale i ka kthyer përgjigje sot shqetësimit të qytetarëve të Korçës dhe kryebashkiakut Sotiraq Filo në lidhje me projektin e ndërtimit të një TEC-i në afërsi të Korçës. Njëpërmjet një reagimi në rrjetet sociale, ai ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për një projekt konkret, por për një miratim në parim si investim strategjik. "TEC-i Korçës një zurmë tipike e politikës së sajësive për sherr! S'ka asnjë autorizim e asnjë leje jo e jo, po thjesht një miratim në parim si investim strategjik. Për sa kohë s'ka një projekt të standardeve të BE-së, s'ka asnjë shans jo për të nisur punë, po për asnjë autorizim!", - shkroi Klosi. Pjesë e këtij debati është bërë edhe ish-kryetari i Bashkisë së Korçës, Niko Peleshi, i cili ka qenë edhe ministër Bujqësie. Njëpërmjet një statusi të gjatë ai ka sqaruar se si ish-ministër i Bujqësisë është shprehur kundër

#### SHKURT

### Balla "konfirmon" Kastriot Gurrën për një tjetër mandat në Librazhd

Bashkia e Librazhdit ka bërë të mundur rikonstruksionin total të kopshtit në lagjen Semes në periferi të qytetit ku edukohen një numër i konsiderueshëm fëmijësh. Në hapjen e tij ishte dhe kryetari i Grupit Parlamentar Taulant Balla përgëzoi Kryetarin e Bashkisë së Librazhdit Kastriot Gurra për punën e bërë në drejtimin e bashkisë për 4 vite, duke bërë kështu një lloj konfirmimi të një rikandidimi të mundshëm të tij. "Në krye të Bashkisë së Librazhdit kemi pasur një njeri shumë të përkushtuar, siç është Kastrioti, i cili ka ditur, si një kryefamiljar i mirë e një familje të madhe, t'i ndajë ku janë nevojat. Pas qendrës shëndetësore, kopshtit, pas sistemimit të qendrës së lagjes, pas sistemimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, besoj që bashkia ka shlyer detyrimet e veta. Megjithatë, për të gjithë ne çështja më e rëndësishme mbetet ajo e punësimit ku kemi plot të rinj e të reja të cilët janë pa punë dhe beteja jonë me punësimin është një beteje të cilën duhet ta fitojmë së bashku", - deklaroi Balla

### Sulmet me vezë dhe bojë ndaj Ramës, Kuvendi merr masa për sigurinë

Situatat e vitit që lamë pas dhe të muajve të parë të këtij viti kur në drejtim të kryeministrit Rama dhe të kabinetit qeveritar janë hedhur që nga vezët e deri te boja, kanë detyruar Kuvendin që të marrë disa masa shtesë për të rritur sigurinë brenda godinës së seancave plenare. Për të parandaluar përsëritjen e ngjarjeve të tilla, mësohet se Kuvendi ka nisur procedurat për mirëmbajtjen e skanerëve dhe të detektorëve ku kalojnë deputetët. Mësohet se tenderi për mirëmbajtjen e skanerëve dhe të urës së detektorëve do i kushtojë Kuvendit 3.3 mln lekë të vjetër. Por masat për të rritur sigurinë në Kuvend nuk ndalet me kaq. Mësohet se një tjetër tender është hapur për traun e sigurisë. Ky shërbim përfshin mirëmbajtjen e traut të sigurisë.

ndërtimit të këtij TEC, pasi ai dëmton zhvillimin bujqësor të zonës. Ndaj ai ka theksuar se edhe qeveria do të reagoi pozitivisht në favor të kërkesës së pushtetit vendor. "Jam i bindur që reagimi i ministrave do të jetë i shpejtë dhe konform ligjit duke

refuzuar autorizimin dhe lejen mjedisore për arsyet që z. Filo i parashtron më së miri në letrë. Së dyti, në asnjë rrethanë nuk mund të ndërtohet ky TEC, përderisa bashkia që përfaqëson interesin e qytetit është kundër", - shkroi ndër të tjera Peleshi.



Kreu i PD-së ka theksuar se parlament monoparti dhe qeveri të inkriminuar s'mund të ketë

# Basha mbledh kryesinë: Largimi i Ramës çështje e emergjencës kombëtare

Basha mori pjesë në protestën e banorëve të Astirit

Gati 1 javë nga mbajtja e protestës së radhës, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka mbledhur kryesinë e re me të cilën ka ndarë porositë organizative në mënyrë që të garantohet një pjesëmarrje sa më e lartë në 16 mars. Mbledhja ka zgjatur rreth 1 orë dhe burime pranë saj kanë bërë me dije se kryepozitari ka theksuar se është e domosdoshme që protesta e ardhshme të kalojë atë të 16 shkurtit, si për nga pjesëmarrja ashtu edhe për nga mesazhet që duhet të përcjellë qeverisë dhe opinionit publik. Të njëjtat burime kanë theksuar se kryedemokrati Basha e ka konsideruar largimin e kryeministrit Edi Rama si emergjencë kombëtare. Deri atëherë ai ka siguruar anëtarët e kryesisë se vendi nuk do ketë normalitet dhe se qeveria do jetë nën presionin e qytetarëve. "Largimi i Ramës është e emergjencës kombëtare, në vend nuk ka normalitet, për Ramën asnjë minutë qetësi. Shqipëri me parlament monoparti dhe kriminelë dhe qeveri të kapur me krimin, ne nuk pranojmë" - mësohet të ketë thënë Basha në këtë mbledhje. Gjithashtu ai ka porositur anëtarët e kryesisë që sipas zonave që mbulojnë të kërkojnë edhe nga drejtuesit e tjerë vendor që të kontaktohen sa më shumë njerëz, t'u flitet për gjendjen dhe të ftohen të marrin pjesë në protestë. "Të mbajmë lart frymën antieqeveritare, të bëjmë për vetë elitën e çdo fushe. Gjithçka në funksion të aksionit politik dhe protestave", - mësohet, gjithashtu, të jetë shprehur Basha.



**MANDATET**  
Je ilegjitim! Ndaj sot nga unaza kam një mesazh për çdo qytetar: ka ardhur koha që vendimet t'i merrni ju! Djegja e mandateve është vendimi më i ligjshëm, demokratik dhe patriotik. Me këtë vendim dolëm në krah të popullit. Për të kthyer vendimmarrjen tek populli, ky është vendimi që kemi marrë, unë si kryetar i PD dhe aleatët tanë, për të mos qëndruar në krah të kriminelëve, por në krah të popullit.

**SHKURT**

## Kriza, KQZ i kalon sot mandatet 6 deputetëve të rinj

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka parashikuar të bëjë sot zëvendësimin e 6 mandateve të tjera të lëna nga deputetët e PD dhe LSI. KQZ ka lajmëruar mbajtjen e mbledhjes së radhës sot ku ndër të tjera është edhe plotësimi i 6 vakancave të krijuara si rrjedhojë e dorëzimit të mandateve të deputetëve nga deputetët e PD dhe LSI. Në rendin e ditës të mbledhjes KQZ ka parashikuar dhënien e mandatit të deputetit Astirit Veliajt, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, Lefter Maliqi. Ndërsa vendin e lënë bosh nga Viktor Tushaj i LSI në Lezhë do ta zërë Elda Hoti. Sakaq, Nora Malaj, e zgjedhur deputete në Durrës nën siglën e LSI, e zëvendëson Edlira Hyseni. Mandatin e Vangjel Tavos po nga LSI në Gjirokastrë, KQZ do t'ia japë Ediola Brahës. Ndërsa vendet e dy demokratëve Gent Strazimiri dhe Klevis Balliu në Tiranë dhe Korçë do t'i zënë në Kuvend respektivisht Ajlinda Halilaj dhe Ligorag Karameho.



## "Rama ik" edhe në Athinë, emigrantët protestojnë kundër qeverisë

Me thirrjet "Rama ik" dhe "E duam Shqipërinë si gjithë Europën", emigrantët shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Greqi, protestuan dje para ambasadës shqiptare në Athinë kundër qeverisë së Edi Ramës. Megjithëse protesta u organizua nga dega e PD në Greqi, ajo u mbështet edhe nga bashkatdhetarë të paangazhuar politikisht, pa dallime partiake. Me fjalimet e mbajtura para ambasadës, protestuesit kërkuar largimin e qeverisë së Edi Ramës për t'i hapur rrugë zgjidhjes politike në vend. Ata e cilësuan qeverinë "Rama" si hajdute dhe mashtruese, që ka braktisur interesat e qytetarëve të vet, që nuk do t'ia dijë për premtimet e dhëna për të lehtësuar jetën e emigrantëve shqiptarëve në Greqi. Kryetari i degës së PD në Greqi, Fatmir Gjoci dhe protestues të tjerë u shprehën se kjo qeveri ua ka nxirë faqen shqiptarëve në emigracion me imazhin e kanabizimit dhe të kryeministrit që përkrah kriminelët dhe ka ardhur në pushtet me blerjen e votave nga krimi.

## Kryemadhi: PS me 50 deputetë, Rama 5 i ka vjedhur dhe 28 i ka blerë

Nga Fushë-Kruja ku mori pjesë në një takim me strukturat partiake në kuadër të organizimit të protestës së ardhshme, kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi deklaroi se mazhoranca ka 5 deputetë të vjedhur dhe 28 të tjerë të blerë. Sipas saj nëse votimi në 2017 do të ishte i ndershëm, PS nuk do të kishte më shumë se 50 deputetë. "Ai parlament është ilegjitim. Kjo do të thotë se PS minimumi i ka 5 deputetë të vjedhur dhe 28 të blerë. Pra do të thotë që PS në atë parlament po të kishte qenë votim i ndershëm do të kishte më pak se 50 deputetë. Atëherë ky njeri që nuk çon para drejtësisë shkaktarët e këtij procesi, ky njeri që nuk thotë asnjëherë më fal, ky njeri që nuk konsideron ashtet, as parlament as institucione. Ky njeri që shkriu me qëllim Gjykatën Kushtetuese, që opozita mos kish të mundësi të ankoheshe, ky



njeri ka kapur shtetin dhe e përdor siç do vetë dhe e ndan me krimin e organizuar", - tha Kryemadhi. Gjatë takimit, Kryemadhi u shpreh se djegia e mandateve ishte një veprim ekstrem, por i detyrueshëm në një vend që po shkon drejt diktaturës. "Ne dogëm mandatet, një veprim ekstrem, por i domosdoshëm dhe i detyrueshëm në vend që po shkon drejt diktaturës. Djegja e mandateve për hir të së vërtetës ishte një nga veprimet më të rëndësishme. Edhe kur është krijuar LSI-ja, qëllimi kryesor ishte integritimi i vendit në BE", - tha Kryemadhi. Ndërkohë që më parë,

gjatë ditës së djeshme ajo zhvilloi një takim tjetër në Lezhë, ku theksoi se vendi dhe shqiptarët ndodhen përpara një të keqe të madhe, që e ka emrin rilindje dhe që përfaqësohet nga kryeministri Edi Rama. "Sot jemi në një situatë shumë të vështirë, sot gjendemi përballë një lufte të madhe, dhe lufta nuk ka të bëjë me një individ, nuk është individi, nuk është Edi Rama lufta jonë. Edi Rama është një njeri, i cili ka marrë një pushtet, por, në fakt, pushteti nuk është në duart e tij, pushteti është në duar e një grupi kriminal, që e përdorin atë si një vegël për ta menaxhuar dhe për të drejtuar timonin e famshëm drejt një rruge pa krye, drejt një rruge që largon Shqipërinë nga Bashkimi Europian, largon Shqipërinë nga zhvillimi, largon Shqipërinë nga ajo rrugë, e cila të gjithë kemi aspiruar ndër vite", - u shpreh Kryemadhi.

masave madhore. Këtu vendimet i mori mafia, Damian Gjikuuri dhe ata të lidhur me të", - tha kryetari i PD-së në fjalën e tij para banorëve të Astirit. Ai theksoi se projekti i Unazës së Re ishte rasti më flagrant që tregoi hapur se sa me lehtësi vjedh qeveria paratë e taksapaguesve shqiptarë: "Rama përfaqëson lllumin e kësaj shoqërie që ka ardhur koha ta pasurojmë. Koha e hajduteve merr fund së bashku me Edi Ramën. U kap me presh në duar, këtu tek Unaza e Re, tek Teatri, nga 'Zëri i Amerikës', dhe tani ver-

dikti është i qartë, Rama nuk merr dot asnjë vendim tjetër", - shtoi Basha.

**MESAZHI**  
Nga Astiri ai ka theksuar se tashmë qeveria dhe mazhoranca është e paligjshme dhe se qytetarët tashmë duhet të marrin fatin e tyre në dorë. "Je ilegjitim! Ndaj sot nga unaza kam një mesazh për çdo qytetar: ka ardhur koha që vendimet t'i merrni ju! Djegja e mandateve është vendimi më i ligjshëm, demokratik dhe patriotik. Me këtë vendim dolëm në krah të popullit. Për

të kthyer vendimmarrjen tek populli, ky është vendimi që kemi marrë, unë si kryetar i PD dhe aleatët tanë, për të mos qëndruar në krah të kriminelëve, por në krah të popullit. Kuptimi i këtij vendimi është që tashmë kemi hapur rrugën që do vendimmarrje tjetër, të kthehen tek populli, populli duhet të vendosë. Për t'i hapur rrugë zgjidhjes që ne kemi propozuar, është vendimi i vetëm që i hap rrugë kësaj zgjidhjeje", - tha Basha.

## INTERVISTA KRIZA

Deputetja e PS vlerëson se ligjërisht parlamenti do të jetë afatgjatë deri në 2021

# Kriza politike, Kumbaro: Ekzistojnë dy skenarë si mund të ecet më tej

"Ky është një atentat ndaj demokracisë në përgjithësi"

**A**tentat ndaj demokracisë. Kështu e konsideron ish-ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro vendimin e opozitës për të djegur mandatet duke kërkuar largimin e një qeverie legjitime. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" Kumbaro tekta komenton situatën politike në vend, shprehet se sjellja e opozitës përveçse po përpjet të godasë parimet e demokracisë, por dëmton rënd edhe procesin e integritetit të vendit në BE. Sipas saj humbjet e njëpasnjëshme të opozitës në zgjedhje, por edhe frika nga institucionet e reja të reformës në drejtësi janë shkaqet e "irracionalitetit dhe tërheqjes në greminë të të gjithë opozitës aktuale". Ajo rendit dy skenarë se si mund të ecet më tej për të dalë nga ky ngërç: i pari është që të vijohet me plotësimin e vendeve vakante, ndonëse e pranon se kjo sjell normalitet dhe skenari i dytë ai i uljes në tryezën e dialogut. Nderkohë që ajo ndonëse nuk i sheh deputetët e rinj si një opozitë e re, shprehet se Kuvendi ligjërisht do e vijojë mandatin deri në vitin 2021. Duke folur më pas për qeverisjen, Kumbaro ka komentuar edhe ndryshimet në qeveri. Ajo thekson se ndryshimet në qeveri ishin më se normale në mes të mandatit të dytë qeverisës dhe aq më shumë pas protestës së studentëve. Kumbaro ka komentuar edhe raportet e marrëdhënieve me kryeministrin.

Zonja Kumbaro vendi po përballat me një përplasje të fortë politike, ku veç protestave të dhunshme, opozita ka ndërmarrë dhe një akt ekstrem dhe të precedent, atë të djegies së mandateve të deputetëve. Çfarë po ndodh? Keni një koment?

Çfarë po ndodh, është pyetja që bëjmë të gjithë. E bëjmë në që jemi në mazhorancë, njerëzit kudo nëpër Shqipëri, ndërkombëtarët çdo ditë, por edhe vetë anëtarë të opozitës që janë të përçarë e të çorien-



Ish-ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro

tuar, sepse shohin përballë murin që po i bihet me kokë dhe jo perspektivë të qartë. Komenti im është se ky është një atentat ndaj demokracisë në përgjithësi dhe përtej Shqipërisë, por dhe atentat kundër procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

**Opozita nga ana e saj ka bërë kalë të betejës së saj politike pikërisht akuzat për vjedhje votash, tekta për disa muaj me radhë ka kërkuar largimin e kreut të Bashkisë së Durrësit, si**

### PËR PROTESTAT

"Protestat e studentëve ishin alarmi i duhur, në kohën e duhur e në mënyrën e duhur për ta kuptuar e aktualizuar këtë nevojë. Personalisht jam ndjerë krenarë për studentët që protestuan dhe ka qenë një mësim shumë i mirë për politikën, por edhe për shoqërinë shqiptare"

të implikuar në blerjen e votave. Nëse mazhoranca do ishte përgjigjur më parë kësaj kërkesë të opozitës mund të ishte shmangur kjo situatë?

Akuza që vijën si retorikë politike në rrugë, nuk mund të sjellin tjetër reagim të mazhorancës përveç kërkesës për t'u drejtuar organeve të drejtësisë. Nuk e imagjinoj se si mund të reagohe ndryshe. Çdo sjellje tjetër është përdunim i institucioneve dhe arbitraritet. Mazhoranca nuk është as prokurori as gjykatë. Dhe kjo mazhorancë e ka treguar se kur drejtësia ka folur kemi respektuar një më një vendimet e saj. Po kështu kur ne si mazhorancë mendojmë se kemi vend për të bërë një akuzë i jemi drejtuar organeve të drejtësisë.

**Cilat janë sipas jush arsytet e vërteta të kësaj sjellje nga ana e opozitës?**

Dëshpërimi nga humbjet e akumuluar dhe nga dëshimet që ka ndërtaur me duratë e veta liderhipi i opozitës, por edhe frika e liderhipit historik të kësaj opozite nga hyrja në fuqi e aksionit të SPAK dhe të organeve të vetingut. Kjo shpjegon irracionalitetin dhe tërheqjen në greminë të të gjithë opozitës aktuale.

**Nderkohë që tashmë ajo**

**PËR MANDATET**  
"Çfarë po ndodh, është pyetja që bëjmë të gjithë. E bëjmë në që jemi në mazhorancë, njerëzit kudo nëpër Shqipëri, ndërkombëtarët çdo ditë, por edhe vetë anëtarë të opozitës që janë të përçarë e të çorientuar, sepse shohin përballë murin që po i bihet me kokë dhe jo perspektivë të qartë. Komenti im është se ky është një atentat ndaj demokracisë në përgjithësi dhe përtej Shqipërisë, por dhe atentat kundër procesit të integritetit evropian të Shqipërisë"

**e ka bërë fakt të kryer djegjen e mandateve. Si do vazhdohet më tej, do zëvendësohet opozita në parlament?**

Fatkeqësisht pjesa më e madhe e deputetëve të opozitës e ka bërë fakt, ndonëse, ju siguroj, ka prej tyre që brenda vetes së tyre dhe nën zë nuk e miratojnë këtë gjë. Ashtu sikurse ka të tjerë që hapur janë shprehur dyshues uje kundër.

Dhe për t'u përgjigjur pyetjes tuaj shoh dy skenarë:

I pari është ligjor dhe po ndodh; krijohet vakanca në parlament dhe ligji i hap rrugën kandidatit tjetër në listën e partisë përkatëse për të zënë vendin në parlament. Deputetët e rinj të opozitës po zënë vend, a do plotësohen vendet apo jo, mbetet për t'u parë. Por ngado që ta rrotullosh situatën kjo nuk është normale dhe nuk mund të shtremi sikur jemi në një proces normal të marrjes së mandateve, sepse as lënia e mandateve nuk ishte një proces normal.

Skenari i dytë është ai që kërkojmë dhe urojmë: ulja në tryezë për të dialoguar dhe për ta futur situatën në shpatull të kushtetutës dhe të kuvendimit institucional. Por theksoj të ulemi për dialog në interes të Shqipërisë dhe jo për pazar në interes të një



partie.

Skenarin e parë s'e ndalojmë dot, të dytin duhet ta nxisim e ta inkurajojmë. Ne jemi gati.

**Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje për dialog, ndërkohë që kryeministri ka deklaruar se është i gatshëm të dialogojë, por jo të negociojë. Në këto kushte çfarë mund të negociohet?**

Përgjigjia e kësaj pyetjeje gjendet te skenari i dytë që përshkova pak më parë. Pra nuk bëjmë pazar me qeverisjen dhe me institucionet, nuk bëjmë pazar me reformën në drejtësi, nuk bëjmë pazar me rolin që duhet të luajnë institucionet dhe që nuk mund të zëvendësohen nga vullnetet e individëve, qofshin dhe kryetarët e partive. Dialogu në tryezë dhe ndalimi i dhunës dhe i nxitjes së saj është hapi i parë drejt gjetjes së zgjidhjes.

### PËR MINISTREN

"Skuadra e Kulturës është një skuadër e konsoliduar tashmë dhe drejtimi i saj nga Elva Margariti është garanci për sukses dhe për ide bashkëkohore. Më vjen shumë mirë që një zonjë drejton punët e kulturës dhe jam e bindur se do të lërë gjurmën e vet me shije dhe elegancë"

**Mund të kemi marrëveshje tjetër politike mes mazhorancës dhe opozitës për të shtyrë datën e zgjedhjeve lokale dhe mbajtjes e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare?**

Nuk shoh asnjë arsye për të shtyrë zgjedhjet lokale që janë shpallur tashmë në përputhje me Kushtetutën nga Presidenti i Republikës. Dhe as për zgjedhje të parakohshme parlamentare, sepse parlamenti që kemi është zgjedhur në mënyrë të ligjshme dhe të gjithëpranuar, po kështu dhe qeveria është krejt legjitime. Shqipëria ka një prioritet që është mobilizimi i të gjitha forcave për të mbërritur në finish të negociatave. Ky nuk është prioritet i Partisë Socialiste, por i shqiptarëve dhe ta sakrifikosh këtë për interesa të cilësdo parti është meskimitet i rrezikshëm.

**Po nëse opozita nuk merr pjesë në zgjedhjet vendore a do mbahen ato?**

Jemi ende larg kësaj momenti, por Partia Socialiste nuk e ka vënë në diskutim dekretin e Presidentit për zgjedhjet e shpallura në 30 qershor. Ama kryefjala tani është të mbërrim në dialog dhe të ruajmë stabilitetin e vendit i cili po dëmtohet çdo ditë në kurriz të shqiptarëve.

**Në Kuvend po krijohet një opozitë e re, me deputetë të rinj. Sa jetëgjatë mund të jetë një parlament me një opozitë të tillë?**

Nuk më duket se është ende një opozitë e re. Janë deputetë të rinj të së njëjtës opozitë, të të njëjtave parti. Dhe ligjërisht parlamenti do të jetë afatgjatë deri në zgjedhjet e ardhshme në 2021. Nëse me këta zëra



← të rinj do të kemi më vonë një reformim apo rinovim të forcave politike në opozitë, kjo mbetet për t'u parë.

Ju vetë personalisht deri para pak muajsh ishit pjesë e qeverisë, ndërsa tashmë deputetë. Për ju që e keni parë qeverinë edhe nga brenda edhe nga jashtë, si do e vlerësoni qeverisjen dhe çfarë duhet të ndryshojë si reagim edhe ndaj këtyre protestave?

Qeverisja është gjithmonë një rrugë me sfida, por edhe një ekuacion ku duhet të zgjidhësh të panjohura. E them pa ngurrim se është bërë një punë gjigande, që ndoshta nuk duket nga jashtë sa duhet, dhe mbase koha do ta tregojë, sepse do duhet qetësi për këtë. Unë vetë arrij ta perceptoj më mirë, tani që jam jashtë, punën kolosale të bërë nga Ministria e Kulturës se sa kur isha në detyrë, pasi ritmi është i tillë që nuk ke kohë të kthesh kokën pas, por duhet të orientohesh për të përgatitur ditën, javën, muajin, vitin që vjen. Nga ana tjetër, secili nga ne ka një rol bashkëpunues dhe konstruktiv për të luajtur në mazhorancë, qoftë si ministër, qoftë si deputet, asnjëri nuk bën dot pa tjetrin. Përtej punës dhe aritjeve, jam e ndërgjegjshme se nuk kemi bërë dot sa kemi dashur, dhe se ende mbetet shumë, e për këtë s'është humbur asnjë ditë. Protestat e studentëve ishin alarmi i duhur, në kohën e duhur e në mënyrën e duhur për ta kuptuar e aktualizuar këtë nevojë. Personalisht jam ndërjerë krenare për studentët që protestuan dhe ka qenë një mësim shumë i mirë për politikën por edhe për shoqërinë

shqiptare.

**Zonja Kumbaro si e pritët vendimin e kryeministrit për të bërë një operacion të thellë në qeveri, duke ndryshuar më shumë se gjysmën e ministrave, përfshirë edhe ju?**

Për mua është një vendim normal për një mazhorancë qeverisëse dhe në tagrin e kryeministrit si kapiten skuadre, që të formojë, ndryshojë apo rinovojë skuadrën e vet duke ndryshuar rolet e aktorëve brenda skuadrës. Akoma më e parashikueshme është kjo lëvizje në mandatin e dytë dhe në një moment kur shoqëria reagon me pjesën e saj më të shëndetshme siç janë rinia dhe studentët. Do të ishte miopi të mos e shohësh dhe mundësinë e mos reagojsh. Kjo mazhorancë ka

## PËR OPOZITËN

"Dëshpërimi nga humbjet e akumuluar dhe nga dështimet që ka ndërtuar me duart e veta lidhshipi i opozitës. Por edhe frika e lidhshipi historik të kësaj opozite nga hyrja në fuqi e aksionit të SPAK dhe të organeve të vetingut. Kjo shpjegon irracionalitetin dhe tërheqjen në greminë të të gjithë opozitës aktuale"

treguar disa herë në këto tri muaj 6 vite, se është e ndjeshme ndaj zërit të shoqërisë, se di të reflektojë, se di të reagojë, së di të kërkojë ndjesë dhe të korrigjohet dhe se ka mjaftueshëm forca drejtuese, politike, ekzekutive dhe intelektuale për të mbetur forca e padyshimtë në rolin qeverisës të vendit.

Mirela Kumbaro komenton largimin e saj nga qeveria dhe marrëdhëniet me kryeministrin

# Largimi nga qeveria? Ish-ministria: Do ishte miopi të mos reagohej

"Nuk merrem me telenovelat bajate që shpikin lot"

## PËR RAMËN

Si në një skuadër që ndërton projekte dhe ka vizion. Marrëdhënie bashkëpunimi dhe këmbimi të ideve nga më të thjeshtat deri të më të vështirave, por bash për këtë edhe të bukura. Prova për këtë janë projektet e ndërtuara në këto gati 5 vjet e gjysmë qeverisjeje ku ndërtuam 5 muze të rinj, 4 teatro, pa folur për qindra restaurime në të gjithë Shqipërinë. Më tej, nuk merrem me telenovelat bajate që shpikin lot kur s'dinë si të rrisin klikimet. E thashë një herë.

Gjatë momentit të prezantimit të ndryshimeve prej kryeministrit në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare në fund të dhjetorit, kamerat e televizioneve ju kanë fiksuar emocionalisht të prekur. Çfarë ndodhi, ishte e papritur edhe për ju ky ndryshim apo kryeministri ua kishte komunikuar më parë vendimin e tij për të bërë ndryshime në qeveri?

Nuk më habit më fakti që portalet dhe rrjetet sociale janë të pangopura në kërkim të melodramave politike me të cilat synojnë përtacisht dhe në mënyrë aspak inteligjente të rrisin klikimet. Se ku e patë e se ku e gjetët



ku ju keni pasur dhe një debat publik me të në sallën e Kuvendit ku edhe lotuat ...

Si në një skuadër që ndërton projekte dhe ka vizion. Marrëdhënie bashkëpunimi dhe këmbimi të ideve nga më të thjeshtat deri të më të vështirave, por bash për këtë edhe të bukura. Prova për këtë janë projektet e ndërtuara në këto gati 5 vjet e gjysmë qeverisjeje ku ndërtuam 5 muze të rinj, 4 teatro, pa folur për qindra restaurime në të gjithë Shqipërinë, e qindra aktivitete e programe kulturore jashtë e brenda vendit, sa nuk ishin bërë në 25 vjet. Më tej, nuk merrem me telenovelat bajate që shpikin lot kur s'dinë si të rrisin klikimet. E thashë një herë.

Ju vetë personalisht si do ta vlerësonit punën tuaj në krye të Ministrisë së Kulturës, çfarë do donit të bënit ndryshe?

Unë vij nga përvoja e gjatë prej 3 dekadash e botës akademike, ku më kanë mësuar dhe ku u kam mësuar të tjerëve se vlerësimi më i mirë nuk është ai që i bën vetes, por ai që të bëjnë të tjerët. Nëse do ta nisja nga e para? E vetmja gjë që do kisha bërë ndryshe është se do të kisha treguar shumë më tepër kujdes e vëmendje që projektet e programet e realizuara nga Skuadra e Kulturës, t'i komunikim e t'ua tregonim më shumë dhe çdo ditë publikut, me qëllim që të kuptohet puna që kanë bërë me qindra njerëz punëshumë e fjalëpak.

Po prurjet e reja në qeveri si i patë, a ishin ato të goditura?

Janë zgjedhje që sjellin energji të reja, njerëz të rinj,

## PËR ZGJIDHJEN

"Skenari i dytë është ai që kërkojmë dhe urojmë: ulja në tryezë për të dialoguar dhe për ta futur situatën në shinat e kushtetutës dhe të kuvendimit institucional. Por theksoj të ulemi për dialog në interes të Shqipërisë dhe jo për pazare në interes të një partie. Skenarin e parë s'e ndalojmë dot, të dytin duhet ta nxisim e ta inkurajojmë. Ne jemi gati".

që garantojnë vazhdimësinë e punëve të bëra mirë dhe japin besim për të përmirësuar dhe për të ecur më shpejt në realizimin e programit të parashikuar për këtë mandat qeverisës.

**Keni një koment për pa-suesen tuaj në Ministrinë e Kulturës?**

Skuadra e Kulturës është një skuadër e konsoliduar tashmë dhe drejtimi i saj nga Elva Margariti është garanci për sukses dhe për ide bashkëkohore. Më vjen shumë mirë që një zonjë drejton punët e kulturës dhe jam e bindur se do të lërë gjurmën e vet me shije dhe elegancë.

**Ju përfaqësoni Qarkun e Gjirokastrës në Kuvend. Mund të na thoni e ka përzgjedh PS kandidatin e saj për Bashkinë e Gjirokastrës dhe**

**Përmetit? Mund të na thoni emrat e tyre?**

Ende jo, sepse ky është proces që vazhdon, proces që ka nisur që pas zgjedhjeve lokale të 2015, proces vëzhgimi, bashkëpunimi, por edhe kontestimi, sepse në të dy këto bashki qeverisja lokale ka lënë shumë për të dëshiruar. Në të dy këto njësi vendore bashkitë janë kthyer në histori personale elektorale të kryebashkiakëve. Pikërisht për këtë qeveria ka qenë dhe është shumë e pranshme me investime dhe ndërhyrje të drejtpërdrejta për të kompensuar shërbimet e munguara nga bashkitë, por edhe për të siguruar zhvillim të zonës, çka është tashmë evidente nga Përmeti në Gjirokastrë.

E them këtë me bindje e përgjegjësi duke qenë se e ndjek nga shumë afër Qarkun dhe jam në kontakt të përditshëm edhe me

përmetarët edhe me gjirokastritët. Dhe nuk kam as dyshimin më të vogël se kandidatët e Partisë Socialiste, do të jenë fitues jo vetëm për figurën personale, por edhe sepse do të përfaqësojnë forcën që ka treguar se fiton me program dhe punë për të gjithë, e jo vetëm për militantët e kryebashkiakëve aktualë.

**Një nga bashkitë më me interes është edhe ajo e Tiranës. Si ka drejtuar Vellaj dhe a duhet të rikandidojë ai për një mandat tjetër?**

Tirana është rasti ideal ku puna flet vetë dhe shumë më tepër se të gjitha fjalët tona. Jo më kot në të gjitha qarqet zgjedhësit kërkojnë një kryebashkiak si modeli i Erion Vellajt. Tirana vetëm në 4 vjet është bërë realisht Tirana që duam. Pyetja juaj është aq retorike sa ju e dini dhe vetë.

Portofoli i kredisë për sektorin e bujqësisë pësoi rënie gjatë vitit të kaluar. Sipas Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit 2018 vlera e këtij portofoli ra në 4.75 miliardë lekë, nga afro 5.4 miliardë lekë që ishte një vit më parë. Rënia me 12% gjatë vitit 2018 dëshmon edhe njëherë se kreditimi i këtij sektori ngelet i vështirë, megjithë vëmendjen në rritje të bankave dhe skemave mbështetëse që kanë ofruar qeveria dhe bankat e zhvillimit. Në fillim të



## Kredia për bujqësinë, në rënie edhe për vitin 2018

vitit 2016, qeveria shqiptare dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, prezantuan skemën ambicioze të garancisë financiare për kreditimin e fermerëve. Përmes një fondi garancie 75 milionë euro, fermerëve do t'u krijohet akses në kredi nga bankat tregtare për një shumë prej rreth 300 milionë

eurosh. Në teori, kjo skemë premtonte t'i jepte një stimul të madh kreditimit për bujqësinë nga sektori financiar në vend. Por, rezultatet nuk po duken. Kredia për bujqësinë ra për të dytin vit radhazi gjatë 2018-ës. Problemi kryesor duket se ngelet kapaciteti i dobët i këtij sektori për të

përthithur financime, edhe në rastet kur në lojë hyjnë skemat e garancisë. Kjo dëshmon se është bërë pak për të adresuar problemet reale të bujqësisë, që janë sidomos konkurrueshmëria e ulët, parcelizimi, mungesa e ekspertizës dhe problemet me dokumentet e pronësisë së tokës.

Për subjektet me xhiro deri në 5 milionë lekë në vit, tatimfitimi është zero

# Tatim-fitimi, 25 mijë biznese afat deri në 30 mars për pagesën

*Tatimet: Gjobë kush s'paguan detyrimin në kohë*

Rreth 25 mijë biznese në rang vendi duhet të paguajnë tatim mbi fitimin brenda datës 30 mars, në të kundërt do të gjobiten me 10% të vlerës së detyrimit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përmes një njoftimi u ka kujtuar bizneseve afatet dhe penalitetet.

### DETYRIMI

Bizneset të cilat janë subjekt i tatimfitimit kanë afat deri në datën 30 mars për të paguar detyrimin e tremujorit të parë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i ka bërë thirrje ndërmarrjeve të deklarojnë dhe paguajnë taksën brenda afatit të parashikuar nga ligji, në të kundërt do të ndëshkohen me gjobë në masën 10% të detyrimit që kanë për të paguar. Aktualisht në Shqipëri janë rreth 25 mijë biznese, të cilat paguajnë tatim mbi fitimin. Skema e taksimit është progresiv me tri fasha dhe mbi xhiron e biznesit. Për bizneset me xhiro deri në 5 milionë lekë në vit, tatimfitimi është zero ndaj kjo kategori ndërmarrjesh nuk ka detyrim për të deklaruar.

### LLOGARITJA

Për bizneset me xhiro nga 5 deri në 14 milionë lekë në vit tatim-fitimi është 5%, ndërsa për ndërmarrjet që kanë një qarkullim vjetor më të lartë se 14 milionë lekë, taksa është 15% e fitimit. Ky është viti i parë që biznesi e paguan tatim-fitimin, sipas kësaj skeme. Deri vitin e kaluar, tatim-fitimi paguhej 15% nga të gjitha bizneset me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit. Por, me paketën e re fiskale, qeveria e rriti kufirin në 14 milionë lekë duke ulur taksën për rreth 11 mijë subjekte. Vitin e kaluar, buxheti i shtetit arketoi rreth 275 milionë euro të ardhura nga tatimi mbi fitimin, pjesa dërrmuese e të cilave vijjnë nga biznesi i madh.

### LIGJI

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë hartuar në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Për përcaktimin e fitimit



është shumë e rëndësishme të evidentohen shpenzimet e njohura, ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime duhet domosdoshmërisht të provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, nëpërmjet faturës tatimore me TVSH, faturës së thjeshtë tatimore dhe çdo dokumenti tjetër të përpiluar dhe të lëshuar në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor. Organizata jofitimprurëse përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, dhe e dorëzon në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër. Tatimi i llogarit në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tat-

ueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara si të zbritshme, dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpa-

guesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

### KËSTET PARAPRAKË TË TATIMIT MBI FITIMIN

1. Tatimi mbi fitimin paguhet çdo tremujor ose çdo muaj në formë paradhënie gjatë vitit, bazuar në këste mujore.
2. Administrata tatimore, bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, dorëzuar nga tatimpaguesi brenda datës 31 mars të vitit vijues, llogarit këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për periudhën prill - dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar - mars të vitit të ardhshëm.
3. Këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin, për periudhën prill - dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar - mars të vitit të ardhshëm, i njoftohen tatimpaguesit brenda datës 30 prill të çdo viti.
4. Këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin, përcaktuar si më sipër paguhen nga tatimpaguesit në bazë tremujore ose në bazë mujore.

## Norma e kompensimit të fermerëve

# Tatimet: Ndryshimet e reja që janë bërë në legjislacion

Për disa ditësh kanë hyrë në fuqi shtesat dhe ndryshimet e fundit për normën dhe kompensimin e fermerëve. Në vijim të informimit të tatimpaguesve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar edhe ndryshimet kryesore që janë në udhëzimin për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve

bujqësorë për qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Sipas ligjit norma e kompensimit për fermerët dhe TVSH-ja e shënuar në faturë nga grumbulluesi aplikohet në masën 6%. Personi i tatueshëm blerës, krediton kompensimin prej 6%. Fermeri, për të përfituar nga skema e kompensimit duhet të regjistrohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore për t'u pajisur me NIPT bren-

da dy ditësh pune. Drejtoria Rajonale Tatimore pajis me certifikatë NIPT-i fermerin, duke shënuar si emër "Fermeri A.B." dhe NIPT-in që gjeneron sistemi. Shoqëria grumbulluese që merr furnizimin, përpara se të lëshojë faturën e parë në emër të fermerit, duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit duke i



bashkëngjitur dhe marrëveshjen me fermerin. Në lidhje me mënyrën e plotësimit të faturës tatimore, konsultohuni me shembullin në pikën 2 të nenit 11 të udhëzimit.

Përfundimi i shqyrtimit të dosjeve, Agjencia publikon formularin për pagesat

# ATP/Ish-pronarët, procedurat për pagesa të përshpejtuara

## Pagesa me tri këste, kompensimi nis brenda vitit

Agjencia e Trajtimit të Pronave do t'i japë përparësi kompensimit të pronarëve që kërkojnë pagesë të përshpejtuara. Të gjithë ish-pronarët që kanë një vendim për njohjen e pronës nga ATP-ja, për të përfutur kthimin ose kompensimin duhet të paraqiten pranë agjencisë për të plotësuar formularët për pagesa të përshpejtuara. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20 % të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30 % dhe brenda pesë viteve merr 40 % të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Ndërkohë pronarët, dosjet e të cilëve nuk kanë marrë një vlerësim financiar nga agjencia duhet të shkojnë në gjykatë dhe nuk përfitojnë nga ky proces.

### KËRKESA

Të gjithë subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjithë subjektet kërkuese, të cilët shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar, pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

### TRI AFATET

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara: pagesë brenda një viti, brenda tre vjetësh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant, në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20 % të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30 %, dhe brenda pesë viteve merr 40 % të vlerës së kompensimit, dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pa-

Aneksi nr.3  
FORMULARI nr.2

**APLIKIM PËR KOMPENSIM FINANCIAR ME KËRKESË TË VEÇANTË**

Drejtuar \_\_\_\_\_

Data e paraqitjes së kërkesës \_\_\_\_\_  
Emri/atësia/mbiemri i subjektit që paraqet kërkesën \_\_\_\_\_  
Adresa: \_\_\_\_\_, tel: \_\_\_\_\_  
Nr. i identifikimit personal \_\_\_\_\_  
Emri/atësia/mbiemri i subjektit të shpronësuar \_\_\_\_\_

Kërkoj të aplikoj: (shëno brenda kësadrajt)

1. Kompensim financiar brenda 1 viti   
2. Kompensim financiar brenda 3 vitesh   
3. Kompensim financiar brenda 5 vitesh

Bashkëlidhur, dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë e veçantë për kompensim financiar   
2. Vlerësimi financiar i vendimit   
3. Konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjenin juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes   
4. Vërtetim nga gjykata kompetente nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore   
5. Dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve   
6. Prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku përfaqësuesi të ketë tagrin për të aplikuar për këtë kompensim dhe të ketë tagrin për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre   
7. Vërtetim për numrin e llogarisë bankare   
8. Vërtetim nëse subjektet kanë përfutur apo jo nga dispozitat për ndarjen e tokës bujqësore  RREGULLAT PER KO  
9. Dokument identifikimi   
10. Mandat pagese

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se pranoj dhe jam dakort të aplikoj lidhur me kriteret për kompensim dhe kushtet e vendosura në VKM nr. \_\_\_\_\_, duke vënë në dispozicion vlerësimin financiar të vendimit për t'u bërë pjesë e kësaj procedure.

Nënshkrimi i kërkuetit \_\_\_\_\_

Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre sjell përjashtimin e menjëhershëm nga procedura e mëtejshme si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

**Faksimile e formularit që duhet plotësuar**

### KOMPENSIMI

Ish-pronarët që presin kompensim nga Agjencia e Trajtimit të Pronave duhet të dorëzojnë një dokument shtesë, deklaratë noteriale, e cila është parashikuar si ndryshim në një pikë të të gjithë formularëve.

mpensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit, dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

### PLOTËSIMI I DOSJES

Ish-pronarët që presin kompensim nga Agjencia e Trajtimit të Pronave duhet të dorëzojnë një dokument shtesë, deklaratë noteriale, e cila është parashikuar si ndryshim në një pikë të të gjithë formularëve. Në pikën katër të vendimit të qeverisë thuhet se në të gjithë formularët, që i bashkëlidhen vendimit, paragrafët e fundit ndryshohen, si më poshtë vijon: "marrje dëni mbi efektet e formularit dhe dokumentacionit të paraqitur sipas kërkesave në këtë formular: Unë, i nënshkruari, kam marrë dëni dhe jam i vetëdijshëm se: a) Ky formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit; b)

**SHPLLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 05.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shiujt e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/264/ND+1-2, ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup> me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajlazi me vllere fillestare në ankand 69.216 (Gjashëdhjet e nëntë mijë e dyqind e gjashëndëdhjetë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

### PAGESAT E PËRSHPEJTUARA

1. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 1 viti, atëherë ai përfiton 20% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
2. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 3 vjetësh, atëherë ai përfiton 30% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
3. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 5 vjetësh, atëherë ai përfiton 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
4. Prioritet do të kenë aplikimet që kërkojnë të kompensohen financiarisht brenda 1 viti.

### DOKUMENTET

Dokumentacioni shoqërues që vërteton pronësinë e subjektit të shpronësuar, përbëhet nga:

- a) dokumentacioni ligjor;
- b) dokumentacioni hartografik;
- c) vërtetime për përfitim nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

Prona e njohur për kompensim

Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, pronë vlerësohet, si më poshtë vijon:

- a) Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit;
- b) Prona e kthyer vlerësohet sipas zërit kadastral aktual të saj dhe sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, duke llogaritur diferencën e vlerës, që do të rezultojë nga ndryshimi i zërit kadastral;
- c) Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa pronë që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së.

Paraqitja e të dhënave të pavërteta, të pasakta ose fshehja e tyre sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga çdo procedurë e mëtejshme si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit; c) Me plotësimin e këtij formulari kam dhënë pëlqimin dhe autorizoj ATP-në për verifikimin e plotë të çdo të dhëne, informacioni dhe dokumentacioni që shfaqet në këtë formular; ç) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave per-

sonale"-thuhet në vendim. Më pas dokumenti noterial përcakton pasojat e deklarimit të rremë. "Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore, në rast të vetëdeklarimeve të pavërteta, të pasakta ose fshehjen e tyre konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasyruara në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave në këtë formular",-thuhet në vendim. Qeveria, ngarkon Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë e Trajtimit të Pronës për zbatimin e këtij vendimi.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

**A**gencia e Trajtit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

#### KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

# Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

#### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuarat financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuarat u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Raif Nuri Nastmi, Xhiko Shyqyri Nastmi	644.5	335
Korçë	Ismail Ali Bilbili		347
Tiranë	OSMAN KULLOLLI	1430	2379
Korçë	Sabajdin Shkoza		245
Shkodër	Ruke Frano Zeka (Hila)		3000
Shkodër	Trashëgimtarët Temali		3160
Tiranë	Viril Llagami	570	1175
Tiranë	QAZIM TAFALLA	5405	595
Fier	Tahir Aliaj	3983	3580
Fier	Frederik Vokopola	3000	8660
Gjirokastrë	Romano Tralo	8719	6560
Korçë	Ibrahim Qose	3800	660
Lezhë	Ramadan Hasan Emerllaj		7475
Durrës			549.19
Elbasan	BAFT JAR VOCI		340
Elbasan	PETRIT MIRAKA		4056
Elbasan	Demir Elezi		4200
Kukës	Vish Ahmet Visha		300
Kukës	Alush Xhafer Kola		1998.2
Dibër	Shefik Fejzullaj	6450	4200
Korçë	Sulejman Abdurahman	280	440
Korçë		450	700
Korçë	Zalo Bregu		10372
Durrës	Zeqir Drapo		1640
Korçë	Fiqiri Zenelaku	3355	270
Korçë	Pëllumb Morava	8425	2714.5
Tiranë	Dylaver Toptani		2650
Tiranë	ZYHDI SARACI	13392	19868
Fier	Lame Nanaj		11921
Fier	Harun shehu	6240	3632
Fier	Bajram Goxhaj		8854
Fier	Telo Beja	2570	410
Fier	Ilmi Qallia		11340
Fier	Skender Kapaj		2900
Fier	Qemal Asllani	2600	600
Fier			1500
Fier	Qani Avdiqaj	5000	10760
Durrës	Fatbardh Kupi	270	9830
Fier	Drago Vashitina	128	2200
Korçë	Jovan Zoto	318	622

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Safedin Elmasllari	576	1155
Korçë	Bardhyl Elmasllari	1752	717
Tiranë	AGIM HYKA		76
Lezhë	Isa Lezha	332	343
Elbasan	Myzejen Blloshmi	300	10216
Elbasan	SHAHE KOLA	126	9074
Vlorë	Dhiomidh Babe		409
Vlorë	Vangjel Dhimitriadhi		3000
Vlorë	Lindita Dule	25	438
Vlorë	Mete Shyti	1404	1762
Elbasan	Shpresa Qafleshi	14060	4140
Korçë		42	4526
Vlorë	Gjyslyme Aliaj		800
Fier	Llazi Gjata , Uran Gjata	5000	5050
Gjirokastrë	Koco Muka	4570	456
Korçë	Andromaqi Xhungo		2079
Korçë	Hydri Goroveci		2330
Korçë	Nevzat Xhuti		5919
Shkodër	T rashg. Tushi		6300
Durrës	Sadik Celmeta(Dani)	5324	336
Durrës	Sajmir Alliu		0
Elbasan	NESHAT ZANI		3430
Elbasan	Ceç Bajrami		1840
Fier	Mustafa Hasalla		1000
Fier	Flamur Guri		12380
Fier	Shaban Xhindole		5000
Fier	Dhimiter Dashi		4000
Korçë	Ali Kambo	700	300
Korçë	Hasan Spaho	100	300
Durrës	Hatixhe Xhakoni		25
Korçë	Gurali Doko	2840	1004
Korçë	Avdyl Topalli	924	1102
Korçë	Tanush Frasheri		0
Vlorë	Rafete Bineri		2301
Korçë	Stavri Jorgaqi	761	0
Durrës	Haki Domi	5000	2476
Durrës		200	880
Durrës	Zeqir Hima		225
Elbasan	QAZIM FILJA		5000
Korçë	Xhevair Zace	4773	470
Korçë	Trashëgimtarët Perona	954	676



Durrës		1200	1175
Elbasan	HYQMET KOBURJA	440	2360
Fier	Izet Korreshi	1090	1034
Fier	Halil Vaka	1386	1164
Fier	Kapllan Canka	2460	2478
Fier	Xhaferr Golemi	4013	7544
Korçë	Nadire, Nazmie, Fidarie Zenelaku	5360	640
Korçë	Trashegimtaret Zenelaku	1920	1280
Korçë	Mehmedi Merolli	3498	502
Korçë	VANGJEL THOMA	440	745
Shkodër	Dede Nikolli		4517
Korçë	Barije Pepi, Etem Pepi	1647	2417
Shkodër	Trash. Marubi	1600	250
Fier	Mihat Mebelli		7000
Fier	Anastas Xoxa		2800
Fier	Musa Tusha	900	9610
Fier	MILTO GJINI		85104
Fier	Zarik Nako		6400
Shkodër	Zef Hil Curri		900
Tiranë	Bujar Bylyku	4900	100
Tiranë	EQEREM DASHI	1631.1	0
Durrës	Abdulla Deliallisi		5753
Durrës	Sani Arapi	11445	0
Elbasan	FATMIR LATIFI		4470
Elbasan	SHYQYRI MIRAKA		1456
Fier	Seit Shanaj	3500	500
Kukës	Feriz Lushaj		4640
Vlorë	Brahim Zani	1170	600
Vlorë	Jani Bitri	1050	5480
Vlorë	Stefan Shtrepi	1858	9144
Vlorë	Janul Çuka	11448	2175
Vlorë	Besim Resuli	150	150
Vlorë	Zaim Liko	180	140
Vlorë	Llazar Gega		400
Vlorë	Dhimitraq Doga		1000
Vlorë	Avokati Pergjithshem Shtetit	2400	2600
Vlorë	Ismet Lushaj		2500
Vlorë	Fadil Omari	1125	1275
Vlorë	Ismail Tetovo		300
Korçë	Agron Avdo		1285
Korçë	Fuat Shehu		712
Korçë	Skender Topalli	4906	910
Lezhë	Ndok Llesh Marku	6900	3100
Elbasan	ARIF HALILI	43.4	856.6
Korçë	Raif Zenelaku	4472	55
Korçë	Mihal Kuvartoti		12
Korçë	Dhimitër Ziu	45	3022.8
Tiranë	MASAR AGA	261	155
Tiranë	Komuniteti Mysliman	2622.4	290
Tiranë	Dhimitër Dhimitriadhi	136.6	244.8
Tiranë	SALI MUKA	41736	40295
Gjirokastrë	Sulejman Bejleri	1875	492
Shkodër	Tofik Kadria		6000
Durrës	Mileva Pema		1005
Korçë	Shyqyri Uzhuri		0
Shkodër	Trash. Lutfija		4900
Shkodër	Trash. Lujkaj	5000	1200
Tiranë	ABDULLA KARAJ	500	202
Vlorë	Donika Kristo		820
Vlorë	Vera Koka	600	46
Vlorë	Avdul Kuci	340	5000
Vlorë	Donika Koka	77	783
Vlorë			80
Fier	Hekuran Sulaj	2206	4233
Fier	Feizo Canaj		846
Fier	Xhafo Zcaj		10860
Fier	Abduraman Alushaj		3782
Fier	Shyqyri Minaj		11660
Fier	Abiz Tahiraj	832	1912
Korçë			1050
Korçë	MAZLLEM SLOGU	1491	940
Fier	Ferrik Hyseni		6420
Korçë			1050
Korçë			1050
Durrës			11622
Elbasan	SIGFRID DELIANA		1640
Durrës	Pavlo Pano		2260
Korçë	Ylli Vënxha	10000	930
Tiranë	GAXHERI HYSEN	4075	724
Korçë	Spira Lubonja		1800
Lezhë	Pal Pjeter Pali	8014	0
Gjirokastrë	Mehmet Rexhaj		5630
Tiranë	Alush Tafxhafa, Sulejman Tafxhafa	13710	46290
Dibër	URIM DESPOTI		400
Dibër			675
Durrës	Aristea Nito		1656.25
Durrës			436
Fier	Ibrahim Filaj	1170	182
Gjirokastrë	Janaq Pano		2601
Korçë	Riza Revani	1221	1087.75
Korçë	Edije Laho	437.5	5089
Vlorë	Osaen Osmëni		780
Vlorë	Siat Maze	3900	1600
Fier	Riza Hazizaj	6000	4810
Korçë	Aleko Marko Karanxha	260.8	2044.2
Shkodër	Trash. Pavaci	1000	2580
Fier	Zyk Metushi	5150	5150
Durrës	Bahri Marku	30	70
Shkodër	Filip Frrok Ndoci		4149.8
Shkodër	Xhemile Jemin Kasemi	1000	600
Shkodër	Trash. Çoba		5000
Fier	Mihal Zaka, Vangjel Zaka		170
Berat	Marinaqi Dhima		1125
Elbasan	Tajar Cekrezi	165	11967.2
Elbasan	Zenel Zani		2450
Fier	Shyqyri Balla		5200
Fier	Adite Kurti		4000
Korçë	Hekuran Dilka		2700
Tiranë	HAJDAR GJOKA		8797
Tiranë	YMER TUFA		3000
Tiranë	HIQMET AGOLLI	5496	1074
Berat	Alo Drita, Njazi Drita	1375	14304
Shkodër	Kisha Franceskane	4006	2303
Berat	Hysen Xhafellari		9400
Berat	Alo Drita, Njazi Drita	1375	14304
Berat	Alo Drita, Njazi Drita	1375	14304
Shkodër	Haxhire Malo Ferhati	69	1651
Korçë	Sabri Jonus Lico	470	406
Korçë	Fuat Sulollari	712	75
Berat	Ahmet Hasa		4800
Fier	AGIM RREDHI		12950
Fier	Vangjel Ndoni		11700
Fier	Seit Kurti		10300
Fier	XHEZMI IMERI	10450	1655
Korçë	Azerita Kuci, Majet Haxhin, Sabri Haxhi		526
Durrës	Shëfqet Jakova	1270	380
Gjirokastrë	Ahmet Kataro	2290	900
Korçë	Ali Byrekasi	280	1575
Shkodër	Mark Dode Doda		7737
Vlorë	Halit Myftar Xhelili		24
Vlorë	Remsi Asllani	418	2062
Vlorë	Lejla Tahiri		5000
Vlorë	Ylvi Zinxhira	3227	1673
Korçë	Muhamet Hysni Neziri ( Liço )	714	934
Vlorë	Sinan Jaupi	3413	5000

(vijon)

## PENSIONET FAMILJARE PËRFITUESIT

"Pagesën e marrin jetimët deri në 25 vjeç, masa jo më shumë se 50% e të ndjerit"

Voltiza Duro

**T**ë gjithë ata shtetas që plotësojnë kriteret e pa racaktuara në bazë të ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ju lind e drejta e përfitimit të pensionit familjar. "Gazeta Shqiptare" sqaron sot për të interesuarit, kushtet që duhet të përmbushin për të marrë këtë lloj pagese, dokumentacionin që duhet të dorëzojnë si dhe mënyrën e përllogaritjes së masës së përfitimit. Përkatesisht, pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paafte për punë. Gjithashtu, Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar. Ndërsa në të gjitha ato raste kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ligji përcakton edhe moshën kur përfitohet pensioni familjar nga i/e veja.

### KUSHTET

Pension familjar mund të përfitohet e veja që është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç; që nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur moshën 55 vjeç. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve, kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që është i paafte për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Të gjithë ata jetim që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paafte për punë mund të përfitojnë pensionin familjar. Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paafte për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetimin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paafte për punë. Edhe

# ISSH: Si të përfitoni pension familjar, kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët

*Dokumentacioni që duhet dorëzuar, ja si bëhet llogaritja*



nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të, trajtohen si jetimë dhe mund të marrin pensionin familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëgjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

### LOGARITJA

Pension familjar konsiderohet ai pension që kishite apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërsa kur personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri kur është i vetëm, dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton

është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pensionin familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëgjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

### DOKUMENTACIONI

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për të fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar, përveç kërkesës, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin. Respektivisht ata duhet të paraqesin certifikatën e gjendjes familjare, fotokopjen e letrës së njoftimit elektronik për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë, si dhe certifikatën e vdekjes së të ndjerit në të cilën duhet të jetë shkënuar edhe shkaku i vdekjes. Gjithashtu, aplikuesi për pensionin familjar duhet të

# 50%

### E MASË SË PENSIONIT

Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%.

dorëzojë edhe dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës, si librezë e punës apo vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj. Bashkëgjitur dokumentacioni të mësipërm, duhet të dorëzohen edhe dokumentet që vërtetojnë të qenët në ngarkim të të ndjerit si dhe: vërtetimi i vazhimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, vërtetimi që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, vërtetimi për personin e ve, që është kërkues për punë, vendimi i KMCAP-it për pafatësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë punë etj. Nënvojzime se në kërkesën për pensionin familjar, jetimi që ka moshën ligjore për t'u punësuar, kur nuk vazhdon shkollën, duhet të paraqesë vërtetimi nga Zyra e Punës. Edhe vërtetimi i pagës

### DOKUMENTACIONI

Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:  
 > Certifikatë e gjendjes familjare.  
 > Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës.  
 > Fotokopje e kartës së identitetit për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë.

Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:

- > Librezë e punës.
  - > Vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
  - > Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore.
  - > Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë.
  - > Vërtetimi i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
  - > Vërtetimi-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.
- Dokumentet që vërtetojnë të qenët në ngarkim të të ndjerit/ndjerës:  
 > Vërtetimi i vazhimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar.
- > Vendimi i KMCAP-it për pafatësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë punë.
  - > Vërtetimi i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit.
  - > Vërtetimi për personin e ve, që është kërkues për punë.
  - > Procesverbal që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KM/CAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale.
  - > Vërtetimi i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërit e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetimin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes.
  - > Vërtetimi nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".
  - > Vërtetimi nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit.
  - > Vërtetimi që nuk është i punësuar apo vetëpunësuar, për jetimin që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat).
- Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:  
 > Vërtetimi page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit-tip.  
 > Vërtetimi i pagës mesatare neto për vitin e fundit të punës.

duhet të përfshihet në dosjen e dokumenteve si dhe vërtetimi i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës. Ndërsa të gjithë ata persona që përfitojnë nga ligji "Për pafatësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të

përndjekurve politike" duhet të dorëzojnë vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi kohën e vuajtjes së dënimit, çdo dokument tjetër që vërteton të qenët në punë dhe vërtetimi mbi faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij.

### NJOFTIMI SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e tretë për pasurinë:  
 1- "Ara", me sipërfaqe 1.200 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Katund i Ri, Tiranë në Zonën Kadastrale: 2119, Numri i Pasurisë: 97/1/1, Vol. 2, Faqe. 19761 në pronësi të Albert Seadin Duka i, Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën: 19.152 (nëntëmbëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) EURO ose 2.394.000 (dy milion e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë) LEKE.  
 Ankandi i tretë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 01.04.2019, ora 16:00 në ambientin e Zyrës së përbarueses gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr. kontakti 0699381883.

### NJOFTIMI SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e parë për pasurinë:  
 1- "Trull", me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtës 85m<sup>2</sup>, e ndodhur në Bitinckë, Devoli, në Zonën Kadastrale: 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Faqe. 70, në pronësi të Vasil Fari Mustaku. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën: 8.000 (ete mijë euro) EURO ose 1.000.000 (një milion) LEKE.  
 Ankandi i parë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 15.03.2019, ora 16:00 në ambientin e Zyrës së përbarueses gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr. kontakti 0699381883.

### NJOFTIMI ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shijen e pasurisë ULLISHTE, me sip. 3.400 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, e ndodhur në Fier-Shëgan Lushnje, në pronësi të: Z. Bajram Sefër Skraçi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 1.213.600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet me datë 12.03.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Nasë Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr. telefon 042320227, email: gjyynth@hotmail.com.

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Kujdes nga penalizimet, tarifa e pakthyeshme

# Provimi shteti për mësuesit, zbardhen datat e testimit nga QSHA

## Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët ditën e testit

Voltiza Duro

P prej javës së dytë të muajit mars e në vijim të këtij viti, mësuesit do të nënshtrohen provimit të shtetit i cili do të zhvillohet në ambientet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Kjo e fundit bën me dije se kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 minuta para fillimit të testimit. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot dokumentacionin që duhet të paraqesin ditën e provimit aplikantët e interesuar. "Ditën e provimit kandidatit duhet të jetë i pajisur me: letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti original); kopje të Kartë ID ose Pasaportë; faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes; si dhe kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej tyre, si dhe njohjen e tyre nga MASR, në rast përfundimi të programeve të studimit jashtë shtetit", thekson QSHA. Ndërkohë, kandidatët, të cilët nuk janë pajisur me diplomë të ciklit të dytë të studimeve, duhet të paraqesin një vërtetim nga Universiteti përkatës, ku konfirmohet shlyerja e të gjitha detyrimeve, përfshirë edhe gjuhën e huaj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### SKUALIFIKIMI NGA TESTI

Qendra e Shërbimeve Arsimore bën me dije se nuk do t'u mundësojë kandidatët të cilëve u mungojnë këto dokumente, të marrin pjesë në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.

"Mëshëtetur në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, neni 7, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenin 4 pika 6 të Rregullores, "Për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 82, datë 22.02.2011, e ndryshuar, kandidatët që regjistrohen për provimin e shtetit, duhet të jenë të pajisur me diplomën e ciklit të parë dhe të dytë të studimit, të lëshuar nga IAL-të përkatëse. Neni 7 i ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 thekson sa më poshtë: Neni 7 "Formimi dhe

kualifikimi profesional për ushtrimin e profesionit të rregulluar": "Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislativin në fuqi", nënvizohet në njoftimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

### VLEFSHMËRIA E PAGESAVE

Tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pak-

thyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Në bazë të vendimit Nr. 560, datë 29.09.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore" është parashikuar zhvillimi i dokumenteve të shtetit nga kandidatët, më shumë se pesë herë. "Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën [ëëë.qsha.gov.al](http://ëëë.qsha.gov.al), rubrika lista e kandidatëve. Kandidatët lutemi të paraqiten VETËM në orarin e përcaktuar dhe publikuar në faqen

### RREGULLAT

Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidatit duhet të ketë parasysh se ndalohej marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi; ndalohej duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit; ndalohej komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.

### DOKUMENTACIONI:

1. Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti original);
2. Kopje të Kartë ID ose Pasaportë;
3. Faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes; (Vëmendje: fatura të ketë vulën e bankës përkatëse);
4. Kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej tyre, si dhe njohjen e tyre nga MASR, në rast përfundimi të programeve

\*Kandidatët, të cilët nuk janë pajisur me Diplomë të ciklit të dytë të studimeve, duhet të paraqesin një vërtetim nga Universiteti përkatës, ku konfirmohet shlyerja e të gjitha detyrimeve, përfshirë edhe gjuhën e huaj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi

web të QSHA. Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të njoftoni përpara se të hyni në ambientin e provimit", nënvizon QSHA-ja.

### RREGULLORJA

Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidatit duhet të ketë parasysh se ndalohej

marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi; ndalohej duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit; ndalohej komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbim konsulencë në fushën e redaktimit (*proofreading*) në gjuhën angleze për përcjelljen në publik të informacionit të BSH për vitin 2019".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Ftesë për kuotim kombëtare", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 472,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 18 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


## Dita e Verës parashikohet me shi, Veliaj në dilemë për të shtyrë festimet

Enjta e ardhshme, 14 marsi, ndonëse zyrtarisht është Dita e Verës sa i përket motit do jetë një ditë dimri. Sipas parashikimit të sinoptikanëve pritet të jetë një ditë me shi, çka mund të vështirësojë festimet e organizuara me këtë rast. Kjo duket se ka vënë në dilemë Bashkinë e Tiranës, e cila ka përgatitur një kalendar të ngjeshur aktivitetesh për këtë ditë festive. Bashkia e Tiranës ka parashikuar rreth 50 aktivitete festive për femijë e të rritur; por rreziku i një moti të keq ka bërë që kryebashkiaku Erion Veliaj të kërkojë mendimin e qytetarëve për t'i zhvendosur fes-



timet të dielën, më 17 mars, pra të dielën kur dhe moti pritet të rikthehet i ngrohtë dhe me diell. 'Hej! Më ndihmo imin me një dilemë! Të gjitha parashikimet e motit e japin Ditën e Verës, dt.14 shi me gjy-

ma! Kemi përgatitur 50 aktivitete për femijë e të rritur! A mos ja vlen të tregohemi të zgjuar e t'i bëjmë festimet të dielën, dt. 17? E enjta pushim gjithsesi", shkruan kryebashkiaku në Twitter.

 **Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**STAFF TRANSPORT SERVICES  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Staff Transport Services for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com); [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com) specifying request for information for "Staff Transport Services".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail. This tender will be organized in two phases:

- In the first phase, companies will need to present: references though similar services performed for other companies, list of vehicles, respective licenses.
- In the second phase, short listed companies will need to submit their financial offer.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Staff Transport for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:  
**Tirana International Airport sh.p.k**  
Procurement Department  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **12:00 hrs. on 21 March 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
[srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com)  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)  
[apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

 **Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for pest monitoring and control for premises (3D Service).

TIA is looking to contract a company to undertake these services that will consist in general terms of: Pest monitoring and control service for disinfection, dissection and deratization (3D) service and to maintaining a good level of hygiene, very good sanitary conditions, healthy and clean environment, safe operational premises, in order to prevent as well the spread of the infection or contamination and any animal hazard within TIA premises.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address, until 20 March 2019.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form.

The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked

"PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)"  
The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 March 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com); [vojka@tirana-airport.com](mailto:vojka@tirana-airport.com); [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### INSTITUCIONI PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

#### NJOFTIM – SHPALLJE

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, nënvep 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pikat 2, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së pararakohshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratur;

n Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së pararakohshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. **Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

#### Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpejten e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefon/email*);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetedeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrijn funksione publike". Formulari i vetedeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjërit të botuar nëpërmjetin e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

#### ■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

- Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.
- Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

#### ■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a

#### Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetas shqiptar që përmbush këto kushte:
  - të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
  - të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
  - të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
  - të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
  - të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

- Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
  - të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
  - të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
  - të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

- Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
  - vjetërsisë në profesion;
  - përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
  - kuantifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
  - treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
  - ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magistraturës;
  - informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

- Organet e emërtesës marrin parasysh përmbajtjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

#### Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:  
**Numri telefonit: 042389898**

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Rënia e flokëve,  
shkaktarët dhe trajtimi  
me bimë mjekësore

## KESHILLA



8 këshilla të  
thjeshta për  
të parandaluar  
alergjitë e stinës

# Altin Çekodhima:

◆ Mjeku  
gastroenterolog:  
Polipet në kolecistë  
më të mëdha se  
6 mm duhen  
operuar menjëherë



## Polipet në tëmth, rrezikshmëria që paraqesin

"Mënyrat efikase të  
diagnostikimit dhe trajtimit"

Mjeku gastroenterolog: Polipet në kolecistë më të mëdha se 6 mm duhen operuar menjëherë

# Altin Çekodhima:

## Polipet në tëmth, rrezikshmëria që paraqesin

"Mënyrat efikase të diagnostikimit dhe trajtimit"

Voltiza Duro

**P**rveç gurëve, në tëmth mund të formohen edhe lezionet që projektohen në brendësi të fshikëzës së kolecistës të quajtura polipe. Shumica e këtyre polipeve kanë natyrë beninjë, por nuk mungojnë edhe rastet e polipeve malinjë. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku gastroenterolog dhe endoskopisti, Altin Çekodhima tregon simptomat kryesore që shfaqin pacientët e prekur, llojet e polipeve të tëmthit si dhe rrezikshmërinë që mund të paraqitet për të sëmurët. Sipas mjekut, çdo polip i fshikëzës së tëmthit i shoqëruar me simptoma duhet hequr dhe shton se tek pacientët 60 vjeç e sipër, me polip sesil të madhësisë 10 mm ose më shumë, nëse gjatë ekzaminimit të ekzoskopike EUS ka indikime për malinjitet, rekomandohet kolecistektomia.

**Cfarë janë polipet e kolecistës dhe si mund të zbulohet prania e tyre?**

Lezionet që shfaqen prej murit të fshikëzës së tëmthit dhe projektohen në brendësi të saj quhen polipe të tëmthit. Në pjesën më të madhe të pacientëve ato diagnostikohen (zbulohen) rastësisht gjatë kryerjes së ekzoskopisë së ekzoskopike EUS ose pas heqjes së fshikëzës së tëmthit për shkak të gurëve ose kolikave biliare (dhimbjeve). Edhe pse shumica e polipeve të fshikëzës janë me natyrë beninjë, në disa raste shfaqen edhe polipet malinjë. Zbulimi i hershëm dhe mar-

rja e masave të përshtatshme janë të rëndësishme për trajtimin kurativ dhe jetëgjatësinë.

**Si klasifikohen këto polipe?**

Qëllimi kryesor për menaxhimin e polipeve të fshikëzës së tëmthit është parandalimi i zhvillimit të tumoreve të tëmthit. Polipet e fshikëzës së tëmthit klasifikohen në beninj dhe malinjë. Polipet beninjë ndahen në: pseudotumore (polipe kolesterolik, polipe inflamator dhe hiperplastik); tumore epiteliale (adenoma); tumore mezenkimal (fibroma, lipoma dhe hemangioma); si dhe polipet malinjë të fshikëzës së tëmthit që janë karcinoma (kancer). Ecuria jo e mirë e pacientëve me kancer të fshikëzës së tëmthit do të thotë që është e rëndësishme të bëhet dallimi i polipeve beninjë, malinjë dhe premalinjë.

**Mund të na shpjegojeni në mënyrë më të detajuar rrezikshmërinë që paraqesin llojet e polipeve të sipërpërmendura?**

Studimet e fundit kanë treguar se shumica e polipeve të fshikëzës së tëmthit janë me natyrë beninjë (jokanceroze) dhe se 60-90% e tyre janë polipe kolesterolik. Këto lloje polipesh zakonisht janë më të vegjël se 10 mm. Ndërkohë, polipet inflamator janë të rralla. Ato kanë një incidencë prej 10% të rasteve dhe formohen si rezultat i ashpërsimit të mukozës nga një inflamacion kronik (i zgjatur në kohë). Ato janë më të vogla se 10mm dhe janë me natyrë beninjë (jo kanceroze). Adenomati gjithashtu janë polipe beninjë, por mund të shfaqin natyrë premalinjë me kalimin e kohës. Këto lezionet zakonisht janë të pedunkuluar (me bisht). Shfaqen të vetme dhe mund të sho-

qërohen me gurë në fshikëzën e tëmthit ose kolecistit kronik (infeksion i zgjatur në kohë të tëmthit). Ato variojnë në përmasa nga 5-20mm dhe zakonisht janë të vetme. Adenoma e fshikëzës së tëmthit është e rrallë, por e mirë dokumentuar si tumor beninj epididial. Adenomatosis ose polipet joinflamator të fshikëzës së tëmthit mund të shfaqen tek pacientët të moshës së mesme. Incidenca rritet me rritjen e moshës. Përshkruar fillimisht si gjetje beninjë, mbetet si lesion prekanceroz.



**Cilat janë simptomat kryesore që nuk duhen neglizhuar nga pacientët?**

Paraqitja e shenjave prej polipeve të fshikëzës së tëmthit janë jospesifike dhe të paqarta ose në disa raste nuk ka shenja fare. Për shumë arsye, shpesh polipet e tëmthit zbulohen rastësisht. Megjithatë, disa pacientë mund të kenë nauze, të vjella dhe dhimbje në anën e djathtë, të sipërme të barkut. Ndonjëherë polipet zbulohen gjatë bërjes së ekzoskopisë abdominale. Në mungesë të gjetjeve të tjera ato mund të konsiderohen burim i kolikave biliare (dhimbjeve). Shenja të tjera të polipeve të



Mjeku gastroenterolog Altin Çekodhima

fshikëzës së tëmthit janë dispesia dhe ikteri (zverdhja). Shenjat që lidhen me pseudopolipet siç janë polipet kolesterolik, inflamator ose hiperplastikë përfshijnë: dispesinë, dhimbje në anën e djathtë të barkut, diskomfort (ndjenjë paretatë), kolecistit (infeksion i tëmthit) dhe gurë të tëmthit. Pacientët që riskojnë për polipe malinjë të fshikëzës së tëmthit janë personat mbi 60 vjeç të cilët kanë gurë në tëmth dhe kolangit sklerozant primar. Polipet me risk të lartë janë ata më të mëdhenj se 6mm, të vetëm dhe sesilë (me bazë të gjerë).

**Mund të përmendni disa prej testeve imazherike që përdoren për diagnostikim?**

Ekoja abdominale është parë si ekzaminimi më i mirë i mundshëm për diagnostikimin e polipeve të fshikëzës së tëmthit, jo vetëm për koston më të ulët, por edhe sepse ka ndryshime të mirë dhe është më specifike. Endosonografia (EUS) është konsideruar si metoda diagnostikuese më sensitive për polipet e fshikëzës së tëmthit. Gjithashtu, diagnostikimi me ultratinguj me rezolucion të lartë gjatë EUS për përcaktimin e diagnozës diferenciale të polipeve të fshikëzës, është shumë i saktë.

**Kur lind nevoja për ndërhyrje kirurgjikale?**

Çdo polip i fshikëzës së tëmthit i shoqëruar me simptoma (shenja) duhet hequr. Tek pacientët me faktor rrisht për malinjitet të cilët kanë polip më të madh se 6mm, polip duhet ta operohet patjetër. Pacientët pa faktorë rrisht janë kandidatë për ekzoskopike

EUS për vlerësim të mëtejshëm. Ato polipe që gjatë EUS janë konsideruar me risk të lartë, duhen operuar. Heqja e fshikëzës së tëmthit duhet bërë vetëm në rastet kur kemi shenja klinike prej polipeve, prani të polipeve më të mëdhenj se 10mm, polipe që rriten shpejt, polipe sesile (me bazë të gjerë), polipe me pedunkul të gjatë, polipe të fshikëzës së tëmthit janë personat mbi 60 vjeç, polipe në fshikëzën e tëmthit të pozicionuar në infundibulum, ose mure jo normale të fshikëzës së tëmthit.

**Cilat polipe mund të kthehen në kancer dhe si veprohet në këto raste?**

Ka shumë mundësi që polipe të fshikëzës së tëmthit më të mëdhenj se 18mm të kthehen në kancer. Polipe të fshikëzës që nuk mund të operohen duhet të ndiqen me ekso periodike. Intervali i përsëritjes së çdo ekzaminimi është 6-12 muaj.

**Mund të jepni disa rekomandime për pacientët e prekur nga polipet?**

Tek pacientët 60 vjeç e sipër, me polip sesil të madhësisë 10 mm ose më shumë, nëse gjatë ekzaminimit të ekzoskopike EUS ka indikime për malinjitet, rekomandohet kolecistektomia (heqja kirurgjikale e fshikëzës së tëmthit). Në qoftë se nuk ka shenja për malinjitet, duhet të bëhet ndjekja me të njëjtën metodë ekzaminuese pas 6 muajsh. Në qoftë se edhe pas 6 muajsh nuk kemi ndryshime në madhësi, konture dhe vaskularizim, ndjekja mund të individualizohet çdo 12 muaj. Për polipet me diametër 6-9 mm pa shenja malinjiteti, rekomandohet ekoja abdominale çdo 6 muaj. Nëse edhe pas 6 muajsh nuk ka ndryshime, ekoja rekomandohet çdo 12 muaj dhe më pas në qoftë se përsëri nuk shihen ndryshime bëhen ekzaminime të tjera vlerësuese. Polipet e fshikëzës së tëmthit më të vegjël se 6mm nuk ndiqen me eko nëse nuk tregojnë shenja për malinjitet.

Voltiza Duro

**H**umbja e flokëve është një dukuri normale dhe përgjithësisht ndodh gjatë ndërrimit të stinëve, sidomos në vjeshtë. Disa prej shkaktarëve që dobësojnë flokët janë stresi, pirja e duhanit, ushqyerja e dobët, shtatzënia, apo dhe marrja e medikamenteve të ndryshme. Cikli i rritjes së flokëve ndahet në disa faza të ndryshme dhe është i ndryshëm nga cikli i rritjes së flokut në pjesë të tjera të trupit. Faza e parë e rritjes së flokëve është ajo e daljes nga folikula (rrënja e fijes) deri në sipërfaqe dhe rritja e tij, periudhë kjo që zgjat deri në 7 vjet. Pas këtij cikli fillon të dalë një fije tjetër në këtë folikul dhe kështu e shtyn fijen e parë të fillojë të shkëputet dhe të bjerë, duke dalë fija e re. Ky është një proces normal që ndodh çdo ditë tek çdo njeri. Si çdo proces tjetër në organizëm edhe rritja e flokëve varet nga një mekanizëm në zinxhir. Nëse ç'ekuilibrohen këto mekanizma atëherë flokët fillojnë të bien me shumicë dhe nuk dalin të reja. Ka shumë faktorë që ndikojnë në prishjen e këtij mekanizmi të krijimit të flokëve të reja. Mënyra e të ushqyerit është shumë e rëndësishme e nëse keni mbajtur ndonjëherë dietë, ose nëse ka qëlluar një periudhë që keni qëndruar shumë kohë pa ngrënë, apo nuk i keni konsumuar të gjitha vaktet, flokët fillojnë të dobësohen. Pra, nuk kanë më fortësinë, elasticitetin dhe trashësinë e duhur, ndërkohë që fillojnë të bien sidomos në pjesën e sipërme të kokës me shumicë.

**Shkaktarët**

Çrregullimet hormonale janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rënien e flokëve, veçanërisht problemet me gjëndrat tiroide. Gjatë pubertetit, shtatzënisë apo në menopauzë që ka çrregullime hormonale të mëdha, ka rënie të flokëve, por pasi kalojnë këto periudha flokët fillojnë rritjen normale. Në shumicën e rasteve në këto periudha nuk ka nevojë për mjekime për t'riktuher flokët në normalitet. Në raste shumë të rralla që rënia e flokëve është në të gjithë sipërfaqen e kokës, atëherë mund të jetë çrregullim hormonal, ose problem gjenetik, ku duhen kontrolluar të gjitha vitaminat, mineralet dhe hormonet në organizëm. Infeksionet ose sëmundjet e lëkurës shkaktojnë rënie të flokëve gjithashtu, por vetëm në vende të lokalizuara. Ky është një problem që kurohet lehtësisht, madje edhe në kushte shtëpie. Sëmundjet e lëkurës si ekzema apo psoriasis ndikojnë në rënien e flokëve gjithashtu sepse shkaktojnë irritime në lëkurë. Për këto lloj sëmundjesh nuk ka kurë por mund të përdorni kremra zbutës që të mbajnë nën kontroll lëkurën e kokës dhe kështu nuk do të ndikohet rritja e flokëve. Stresi çrregullon shumë mekanizma në organizëm, dhe një prej tyre është edhe procesi i rritjes së flokëve. Gjëja më e mirë në këtë rast për të arritur një balancë në gjithë organizmin do të ishte të mundahehi të ulni nivelin e stresit duke mos kon-



**Mjeku popullor:** Kujdes nga çrregullimet hormonale dhe problemet me gjëndrën tiroide

# YLLI MERJA: Rënia e flokëve, shkaktarët dhe trajtimi me bimë mjekësore

*"Parandalimi në kohë, përdorni çajin me hithër"*



Mjeku popullor Ylli Merja

sumuar kafe, apo produkte me kafeinë, duke bërë një shëtitje në ajër të pastër si dhe mund të konsumoni çaj me kamomil dhe rozmarinë. Në këtë situatë nuk keni nevojë të përdorni asnjë lloj mjekimi për rënien e flokëve, pasi shkaku i rënies nuk është i jashtëm, por i brendshëm e duke larguar shkaktarin e rënies mund të riktheni flokun në gjendjen e dëshiruar.

**Kurimi me bimë mjekësore**

Kura kryesore përdoret në të gjitha rastet e rënies së flokëve. Kur individët kanë çrregullime hormonale bëhen shtesa të tjera dhe për këtë duhen parë të gjitha analizat e tyre dhe përdoret një

kurë komplekse. Për të ndihmuar në forcimin e rrënjës së flokut përdoret çaji kundër rënies së flokut, i cili përmban gjethe e rrënjë hithre, rozmarinë, bisht kali etj. Ky

çaj ushqen rrënjën e flokut e ndihmon në daljen e flokëve të reja. Pasi lahen flokët me shampo normalisht, shpëlahen me çajin, dhe jo me ujë të pastër. Çaji qëndron



në gjithë flokun duke ndikuar gjatë gjithë kohës në formimin e tij. Floku lahet maksimumi 2 herë në javë pasi larja e shpesh-të e tij ndikon në rënie (largon bakteret e yndyrën e "mirë" që ndodhet në flokë duke e dobësuar në tërësi dhe rrënjën e tij). Nëse e keni të pamundur të gjeni kohë për përgatitjen e çajit mund të përdorni ekstraktin e këtij çaji, i cili ka të njëjtët përbërës duke i spërkatur flokët 3-4 herë në javë. Ky ekstrakt nuk ka aromë apo ngjyrë, thahet menjëherë, gjithashtu, ndihmon në kontrollin e yndyrës në flokët. Gjithashtu, në 600ml shampo shtohet 1 lugë gjelle vaj bajamesh të egra. Shampot përmbajnë paraben, bojëra, aromatizues, të gjitha këto qëndrojnë në rrënjën e flokut dhe e dëmtojnë atë. Vaji i bajames ndikon në zvogëlimin e efektit të këtyre përbërësve, dhe ndihmon në shpëlarjen e tyre sa më shpejt nga floku. Gjithashtu, përmban shumë vitaminë E që ushqen dhe zbut flokun. Çaji shoqërohet me një maskë për flokët që përmban ekstrakt hudhre dhe qepe, ekstrakt bisht kali, vaj livando, kokosi, rozmarinë. Të gjitha këto bëjnë që të largohen të gjitha infeksionet në lëkurën e kokës, si dhe ushqejnë dhe forcojnë rrënjën e flokut. Nëse keni probleme me irritimin e lëkurës së kokës nga psoriasis apo ekzema këshillohet të përdoret maska në vazhdimësi pasi nuk lejon të shfaqet asnjë plagë apo irritim në lëkurë, si dhe normalizon pH e lëkurës.

# 8

## këshilla të thjeshta për të parandaluar alergjitë e stinës

Më ardhjen e stinës së pranverës dhe qarkullimit në ajër të polenit të luleve, jo pak njerëz fillojnë të kenë kruraje e lotim sysh, teshtima të shpeshta e bllokim hundësh; të gjitha këto simptoma kryesore të alergjisë. Më poshtë po listojmë tetë këshilla të thjeshta që do të lehtësojnë sadopak vuajtjet që sjell alergjia e kësaj stine.

### 1. Ndryshoni ajrin e shtëpisë

Mjekët këshillojnë që të pastroni çdo mëngjes ajrin e shtëpisë suaj, duke shmangur kështu alergjenët që mund të ndodhen aty. Sigurisht që polenet janë faktori numër 1 në shfaqjen e alergjisë. Në jo pak rasti është ajri i kondicionuar i përshtatshëm për të pastruar ajrin e dhomës ku ju qëndroni. Mbyllni dritaret për të shmangur ajrin e jashtëm e të ndotur që mund të ndikojë keq në shëndetin tuaj. Vetëm nëse keni perde të përshtatshme për të filtruar pluhurat e jashtme, mbani dritaret hapur.

### 2. Pastroni shpesh hundët

Është e nevojshme për të larguar mukusin e tepërt të hundëve, sepse në të mund të jenë grumbulluar alergjenë të ndryshëm, që organizmi juaj i nxjerr jashtë. Për të pastruar hundët mund të përdorni ujë të kripur të cilin duhet ta spruconi lehtë në hundë. Kjo të ndihmojë që papastërtitë të shmangen. Nëse ju bezdis uji i kripur përdorni ujë të pastër.

### 3. Ushqime të pasura me Omega-3

Sigurisht që edhe ushqimi që konsumoni ka ndikim të ndjeshëm në shëndetin tuaj. Kështu për të shmangur alergjinë konsumoni ushqime të pasura me omega-3. Këto acide gjenden tek peshqit të ngjashëm me salmonin, arrat, lajthitë, farat e lirit e ushqime të tjera. Omega-3 edhe pse nuk është specifike lufton alergjitë nazale.

### 4. Konsumoni rrepat

Për të trajtuar hundët e bllokuara nga alergjia, konsumoni pak më shpesh se zakonisht rrepat. Po ashtu pjesë e dietës suaj duhet të



ajrin rreth tij, sistemi imun është aktiv dhe ndjen uri, por duhet treguar kujdes sepse organizmi është më i prirur të shfaqë alergji ndaj ushqimeve.

### 6. Kryoni aktivitet fizik

Sporti dhe aktiviteti fizik janë gjithmonë të shëndetshëm për organizmin. Ju bën mirë të shëtisni edhe pse mendoni se nëse dilni në ambiente të hapura do të ekspozoheni më tepër ndaj alergjenëve. Pikërisht kjo t'iu ndihmojë që t'i luftoni ato. Të shëtisni në bregdet apo edhe buzë liqenit, apo pranë një lumi do ju bëjë të ndiheni më mirë.

### 7. Përdorni bimë mjekësore

Studimet e raportuara nga British Medical Journal dhe gazeta të tjera kanë treguar se disa bimë barishtore mund të veprojnë si antihistamina. Një lloj bime e quajtur Petadolex mund të shmangë reaksionet alergjike në organizmin tuaj.

### 8. Mos harroni medikamentet mjekësore

Nëse rastet alergjike janë shumë të shpeshta dhe ju ndjeheni të kërcënuar nga këto shqetësime, duhet t'i drejtoheni mjekut specialist dhe të merrni mjekimet e duhura. Edhe pse për momentin trajtimet nazale janë më efikase dhe më të përdorura, më përpara duhet të konsultoheni me mjekun për të parë se çfarë është më e mira për ju.

bëni edhe specat djegës dhe mustardën. Përbërësit e gjendur tek këto ushqime veprojnë ndërmjet tyre natyrshëm, dhe ndihmojnë edhe pse përkohësisht për hundët e bllokuara.

### 5. Shmangni ushqimet që ju shkaktojnë alergji

Duhet të jeni veçanërisht të kujdesshëm për të shmangur në mënyrë absolute ato ushqime që ju shkaktojnë alergji. Kur trupi juaj "lufton" sportet e gjendura në

#### SIMPTOMAT E ALERGJISË:

- Teshtima të shpeshta
- Sy të skuqur
- Hundë të rrjedhshme
- Hundë të bllokuara
- Njolla në lëkurë
- Vështirësi në frymëmarrje
- Në disa raste shoqërohet me kollë të lehtë
- Mund të sjellë ftohje të menjëhershme
- Diarre
- Probleme me tensionin e gjakut

#### ALERGJENËT MË TË ZAKONSHËM JANË:

- ALKOOLI
- THUMBIM I BLETËS APO I NDOJË INSEKTI TJETËR
- PUSHI
- USHQIMI
- POLENI I LULEVE
- BARI, PEMËT, SHKURRET
- PLUHURI I SHTËPISË
- ILAÇET
- MYSHKU
- NIKELI





Protesta e opozitës në Fier, pranga dy të akuzuarve pas analizës së pamjeve filmike

# Plagosja e policit, ndalohen dy persona

## Vizita e kryeministrit Rama shkaktoi protestën e dhunshme

Policia e Fierit ka ndaluar dy persona dhe shpallur në kërkim dy të tjerë pas plagosjes së efektivit të FNSH-së Aranit Karemani gjatë protestës së opozitës në Fier. Mësohet se personat e ndaluar janë shtetasit L.Z 42-vjeç dhe E.K 37 vjeç. Sipas policisë ndalimi i tyre u bë pas analizimit të pamjeve filmike.

Kujtojmë që protesta e djeshme e opozitës, u shfaqur me përplasje të dhunshme me policinë ndërsa kryeministri Edi Rama do të zhvillonte takimin për "Bashkinë që Duam".

### INFORMACION PARAPRAK

Policia e Fierit ndalon 2 shtetas të tjerë të cilët ushtruan dhunë ndaj punonjësve të policisë në protestën e djeshme.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe pas analizimit të pamjeve filmike dhe provave të tjera të grumbulluara, u bë i mundur identifikimi i dy personave të tjerë, të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë në protestën e djeshme në Fier.

Si rezultat, u kapën dhe u ndaluan shtetasit:

L.Z, 42 vjeç, banues në Fier.

E.K, 37 vjeç, banues në Fier.

Gjithashtu, janë shpallur në kërkim edhe 2 shtetas të tjerë për të njëjtat vepra penale.



Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik" dhe "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme".

### PROTESTA

Policia e Fierit ka dhënë informacione zyrtare pas plagosjes së efektivit të FNSH-së Aranit Karemani gjatë protestës së opozitës në Fier. Policia thotë se protestuesit tentuan të çanin kordonin policor dhe se goditën me sende të forta efektivin, i cili ka marrë

mjekim në spital Nderkaq policia po analizon pamjet filmike për zbulimin e autorit.

"Paradite, në vendin e quajtur 'ETC' u grumbulluan për të protestuar rreth 150 protestues me pankarta dhe zhurmues. Gjatë protestës pati tentativa për të çarë kordonin policor, si dhe u goditën me sende të forta forcat e policisë. Për pasojë i plagos në kokë një punonjës policie i FNSH-së, icili po merrndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Fier. Grupi hetimor do të analizojë provat dhe pamjet filmike për të vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e sulmit ndaj punonjësit të rendit", deklaroi policia.

### 35-vjeçari akuzohet për pjesëmarrje në organizatë kriminale

## Kush është boksieri i grupit "Bajri" i arrestuar, historia e atentatit në 2017

Detaje të reja zbulohen për anëtarin e grupit famëkeq "Bajri" të Shkodrës, Nelson Hysën, i cili u arrestua një ditë më parë në kuadër të operacionit "Oaz" në zonën e Komunës së Parisit Tiranë, në një banesë të marrë me qira.

35 vjeçari, boksier i Vlazinë, akuzohet për disa vepra penale si pjesëmarrje në organizatë kriminale, grup i strukturuar kriminal dhe paracaktim të rezultateve në garat sportive në bashkëpunim dhe ishte shpallur në kërkim që prej shtatorit 2018.

Këtij të fundit madje i është bërë edhe një atentat në 7 maj të vitit 2017, gjatë të cilit mbeti i plagosur. Hysa sapo kishte dalë nga një berberhane kur është qëlluar me armë zjarri disa herë nga dy persona të maskuar që udhëtonin me motor.

Pas krimit, policia identifikoi dhe arrestoi autorët e dyshuar Valter Ksolla 21-vjeç dhe Kolë Progni, 25 vjeç.

35-vjeçarit që i shpëtoi policisë 6-muj më parë kur u arrestua Safet Bajri dhe pjesa tjetër e grupit. Koka e grupit kriminal të Bajrave konsiderohet Enver Bajri 45 vjeç, i arrestuar në Spanjë dhe që pritet të ekstradohet në Shqipëri për t'u përballur me akuzat.

Pse ndodhi plagosja në 2017



Referuar burimeve, shkak për këtë plagosje ishte një konflikt për xhirimin e gomave të makinës. Në nëntor të 2018-s, Gjykata e Shkodrës dënoi me 6 vite burg autorin e plagosjes së Nelson Hysës.

Ndërsa nga dëshmitë rezultoi se në datën 3 maj 2017, gjatë orëve të para të paradites, rreth orës 10:00, i dëmtuari Nelson Hysa së bashku me shokun e tij A.D. kanë pasur një konflikt verbal me shtetasin Valter Ksolla.

Ky i fundit drejtonte një autoveturë të markës "Audi A6" dhe ka bërë xhirime të gomave në afërsi të tyre. Rreth orës 12:30, Nelson Hysa së bashku me A.D. kanë qenë duke lëvizur me makinë në rrugën e gjerë, që të çon në lagjen Kiras dhe të një piceri, në anën e djathtë të rrugës, ata kanë parë makinën "Audi" që i kishte xhiruar afër tyre.

Nelsoni ka ndalë makinën dhe së bashku me shokun e tij kanë hyrë në piceri. Aty kanë gjetur shtetasit Valter Ksolla dhe Kolë Progni. Sapo Nelsoni dhe shoku i tij janë futur në piceri, shtetasit

Valter Ksolla dhe Kolë Progni janë ngritur në këmbë nga frika se Nelsoni mund t'i godiste dhe i janë drejtuar Nelsonit me fjalët se, pse po vjen "si i fortë se ne kena hallet tona boll, se jena në gjak".

Nelsoni u ka thënë se nuk kishte ardhur si i fortë, por për t'u sqaruar se pse i kishin bërë spektakël me makinë para këmbëve të tyre dhe para shtëpisë, duke vënë në rrezik ata dhe djalin e tij. Shtetasit Valter Ksolla dhe Kolë Progni janë nervozuar dhe i kanë thënë se do të shihemi më vonë, ndërsa Nelsoni i ka thënë se nuk kemi pse shihemi më vonë, por sqarohemi tani.

Shtetasit Valter e Kolë kanë ikur pa folur më, kanë hipur në makinë duke xhiruar përsëri gomat. Tre ditë më vonë, Progni e Ksolla kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të Hysës, kur ky i fundit po qëndronte përpara një berberhaneje, duke e plagosur rëndë atë.

Balkanweb

### AKSIDENTI

## I përplasi makina teksa udhëtonin me motor, humbin jetën bashkëshortët

Një aksident me pasojë vdekjen e dy personave, ka ndodhur pasditën e djeshme, në aksin Maqellarë-Peshkopi. Burime për "BalkanWeb", shprehen se në aksident janë përfshirë një automjet dhe një motor. Të njëjtat burime bëjnë me dije se nga përplasja ka humbur jetën drejtuesi i motorit, një 34-vjeçar së bashku me bashkëshorten e tij, identiteti i të cilëve ende nuk dihet.

Dyshohet se aksidenti ka ndodhur si pasojë e mungesës së sinjalistikës. Policia dhe grupi hetimor shkuan në vendin e ngjarjes ku po hetojnë rrethanat e mundshme të aksidentit.


"Në aksin rrugor Maqellarë-Peshkopi, sh-



tetasi A.B, duke drejtuar autotjetin e tij, dyshohet se është përplasur me një motoçikletë dhe për pasojë kanë humbur jetën dy bashkëshortët që udhëtonin me

motoçikletë.

Drejtuesi i autotjetit është shoqëruar në Komisarëriat e policisë. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje, njofton policia.



## EMBASSY OF THE STATE OF QATAR

NJOFTIM PUNËSIMI

**AMBASADA E SHTETIT TË KATARIT NË TIRANË KËRCON TË PUNËSOJË:**

1. Sekretare ekzekutive
2. Përkthyes të gjuhës arabe
3. Hulmues ekonomik

**Kriteret:** Sekretarja ekzekutive duhet të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe përvojë në administrim zyre. Përkthyesi të jetë specializuar në këtë fushë dhe të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës arabe.


Hulumtuesi ekonomik të ketë formim arsimor në ekonomi dhe përvojë profesionale në fushën e tij, si dhe njohjen e gjuhës arabe dhe angleze.

Kriteret të përshkëta: Eksperiençë në pozicionin e kërkuar, shkolla e lartë e sipër, të jenë të motivuar, të artikuluar dhe në lartësinë e detyrave që u ngarkohen, dhe njohje e programeve bazë kompjuterike.

Posta elektronike për dorëzimin e aplikimit  
**(e-mail): hr\_embassyqatar@yahoo.com, Tel: +355(4)2274579**

**SPECIALE**  
**KONGRES MBAREKOMBETAR E MODERN**

# Histori e paharruar... 96 vjet, Kongres Mysliman Shqiptar



Xhamia e Namazgjasë, vendi ku muslimanët shqiptarë do t'i drejtohen Zotit të tyre



Ferdinand Samarxhi  
Mjeshtër i Madh

*Historia, na ka parë të përgjakur, por jo të përgjunjur, na ka parë të vegjël, por trima dhe të paepur për liri. Shqiponja jonë Deodoniane, majë malesh e thepash, fluturoi gjithmonë lartë, si simbol i kombit.*

*Fenë, shqiptarët gjithmonë e kanë parë, si një bashkim, identitet të kombit. Edhe kur ekzistenca e tij vihej në pikëpyetje, besimi tek zoti, gjithmonë i ka udhëhequr ata në luftra, duke mbajtur lartë, flamurin e kombit.*

Në rrjedhën e kohës, gjithmonë ngjarjet, datat, ndezin memo rien dhe inkandescencën e kombit. 96 vjet më parë, kur Shqipëria përjetonte, ende kohën e vretur, të lirisë dhe identitetit të saj, kur popuj, perandori të ndryshme nëpërkëmbnin truallin tonë, kur mjegullinaja ob skurantiste kishte tjuurr rrjetën e saj, në gjithë skajet dhe skutat e vendit, ku shqiptarët identifikoheshin nga besimi për kombësi, disa burra më zë si Haxhi Vebi Dibra me shqiptarë të tjerë, do të shkruanin histori të paharruar, do të përgjonin ndjenjat e kombtarisë, kudo ku jetonte kombi ynë.

Kishte ardhur koha, që shqiptarët, më në fund të shthurin rrjetën, ku tashmë ishin mbeshtjellur. Edhe pse koha për ta ishte ende e pamatë, zgjimi për gjithë trojet tona kishte ardhur. Duke shfrytëzuar rrethanat famëkeqe të kohës, të viteve të luftës së parë botërore, kur shqipëria e mesme dhe e veriut ishte e pushtuar nga Austro-Hungarezët, me përkrahje të komisarit civil Austro-Hungarez Kral, të zgjoheshin dhe të zgjidhnin si një të parë, për të gjithë muslimanët e shqipërisë, një Kryemyftiu vendas, që do të organizonte, gjithë jetën e tyre duke pasur edhe një lloj miratimi nga Shejxh-ul Islami në Stamboll. Shkëndija e parë, tashmë kishte ardhë për shqiptarët, për nisjen e organizimit të krijimit të mëvetësisë së tyre. Vjena, duke parë shqipërinë, si një shtet autonom, e jo si një vend i aneksuar prej Monarkisë Habsburge, ishte dakortuar që myslymaët shqiptarë, të kishtin të parin e tyre të fesë islame. Përqasja e Kryemyftiut të parë nga Austro-Hungaria, ishte dhe shenjë e parë e shkëputjes nga Shejxh-ul Islami i Stambollit. Në ndryshim nga Reis-ul-Ulemaja i Sarajevës që ishte pjesë përbërëse e perandorisë Osmane, që në vitin 1909, do të bëhej dhe aneksimi i Bosnje-Hercegovinës nga Austro-Hungaria. Shqiptarët, po hidhnin hapin e parë, për shkëputjen tashmë nga perandoria Osmane.

Tetori i vitit 1916, shënon hapin e parë të mëvetësisë të muslimanëve shqiptarë. Komanda ushtarake austro-hungareze pranoi krijimin në Shkodër, të gjyqit të Naltë të Sheriatit, të përbërë nga Krye Myftiu Haxhi Vebi Dibra, me dy antarë, kryesekretar dhe dy shkruer. Në vitin 1917, Austro-Hungaria miratoi "Shkresën e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri", e cila përbëhej nga 43 nene dhe deri në vitin 1923 luajti rolin e një statuti. Sipas "Shkresës...", i pari i muslimanëve dhe i Sherisë në shqipëri ishte Myftiu i Përgjithshëm. Nën vartësinë e tij, ishin hoxhallarët



Delegatë të kongresit

, Gjyqtarët e Sherisë ashtu dhe zyrtarët. Myftiu i Përgjithshëm kishte drejtimin dhe kontrollin e epërt mbi të gjitha çështjet e muslimanëve, mbi institutet e bamirësisë dhe të arsimit. Bashkë me të parin e muslimanëve qëndronin dhe dy ulema të cilët me Kryemyftiun përbënin Këshillin e Naltë të Sheriatit. Në shkresë thuheshin dhe detyrat e Kryemyftiut dhe Këshillit të Naltë të Sherisë, të Myftive, gjyqtarëve etj.

Hydbet në xhami duhet të mbaheshin në shqip dhe arabisht dhe tu përgjigjeshin urdhrave të qeverisë. Vendimet gjyqësore duhej shkruheshin përherë në gjuhën shqipe.

Duke qenë se shqipëria, tashmë ishte një shtet i pavarur; kishte ardhur koha që lutjet të mos bëheshin më

turqisht por në gjuhën shqipe dhe sulltani të mos përmendej më edhe si sulltan i shqiptarëve.

Çdo gjë tani do të fliste në shqip. Nëpër qytete të shqipërisë, Medresët në Durrës, Shkodër, Berat, Elbasan, Tiranë do të trukturoheshin sipas modelit Evropian. Krahas Lëndëve fetare do të mësoheshin në gjuhën shqipe edhe lëndët laike. Në Elbasan do të ndërtohej një universitet ku do të studioheshin medresistët, gjykatësit e sheriatit dhe dijetarëve të teologjisë. Lufta e shqiptarëve përconte gjithnjë e më shumë në shkëputjen nga turqia, egipti etj dhe të ktheheshin sytë nga oksidenti. Shpallja e pavarësisë në 1912 dhe pas saj, do të gjente shqiptarët të shkëputur përfundimisht dhe me asnjë kontakt me kalifatin Osman. Anjë gjurmë, nuk

duhej të gjendej më për turqit dhe xhonturqit. Gjuha shqipe, ishte bazike, për mëvetësinë e myslymanëve shqiptarë. Këtë rrugë ndoqën dhe kuptuan klerikët tanë të parë patriot myslymanë, se ajo do të ishte dhe shpëtimi i mëvetësisë.

Edhe pse nuk qenë shkolluar në Perëndim, shumë prej tyre në sajë të kulturës islame, njohjes së gjuhëve arabisht, persisht e turqisht patën mundësinë të njihnin thellësisht, sic thotë Fan Noli, rrenjëjt e Qytetërimit Evropian: Përlindjen e shkëlqyer të Persisë, që buronte drejtpërdrejt nga qytetaria greko-romane prej së cilës lindi Përlindja arabe, e cila nga ana e saj përmes Spanjës influencoi Evropën medievale dhe gatiti Përlindjen e madhe italiane, nënën e qytetarisë moderne.

Duke pasur të qartë, dritën e dijës, e cila do ti shpëtonte njëherë e përgjithmonë shqiptarët, jo më kotë të gjithë klerikët, u rreshtuan dhe u vunë në ballë të lëvizjes kombëtare, jo vetëm në saj të formimit të tyre intelektual, por dhe vetëdijësimit kombëtar. Vetë koha, indinjiteti kombëtar i përcaktuar qartë për kombin, kërkonte dhe impononte një organizim të ri të myslymanëve shqiptarë mbi baza kombëtare, proces ky, që kishte filluar, të ndjehesh, shumë kohë më parë, që u bë bazik në kohën e qeverisë së Ismail Agallit, me caktimin e Haxhi Vebi Agollit si Kryemyfti dhe Veisel Nailit si Kryekadi të shqipërisë.

Koha, shtronte nevojën e ngutshme, të mblidhjes të myslymanëve shqiptarë. Edhe pse vendi ishte oku-



Haxhi Vebi Dibra me klerikë të tjerë patriotë shqiptarë, themelues të kongresit



Mbledhja e parë e Kongresit Musliman Shqiptar

puar, gjendja mjaft e keqe ekonomike, nevoja, shtronte zgjedhjen e delegatëve kohën dhe vendin. Për ta cuar, deri në fund, këtë arritje të tyre, myslymaët shqiptarë, mblodhën, Kongresin e Parë Myslyman Shqiptar.

H. Xhemal Naipi, myfti i Shkodrës, në vitin 1917, i dërgoi H. Hafiz Isuf efendi Kelmendit "Rregulloren mbi zgjedhjen e delegatëve për Kongresin e Xhema'ti Islamijes". Votimi do të bëhej me zgjedhës të dytë. Do të kishtin të drejtë vote të gjithë myslymanët, që do të ishin në moshën 21 vjeçare.

**TË SHKRUAJMË SHQIP...**

Nevoja, e gjuhës emë, çdo ditë e më shumë, bëhej më imediate. Shqipëria ishte kthyer në një plazdar të çizmeve, të trupave të huaja. Myftiu i Përgjithshëm, Patrioti Haxhi Vebi Dibra, për të ndalur ekspansionin e tyre dhe përdorimin e gjuhëve të huaja, më 14 dhjetor 1920, i dërgoj, një qarkore, të gjithë Sherive, ku i urdhëronte: të gjitha zyrat e Sheriatit se duhet të përdorin gjuhën kombëtare: "Prandaj, jeni të urdhëruem, mos me përdorë gjuhën turqishte, ndër akte zyrtare, sikurse e kemi përdorë gjër më sot. Nga ky shkak, sekretarët, ashtu dhe shkruesat e gjyqëve sheri, janë të detyruem me ditë gjuhën kombëtare mirë, si me shkrim ashtu edhe me këndim. Veç kësaj, ilameve sheri, përherë do tu ngjitet një shkurtim në gjuhën shqipe". Për të përmbyshur këtë qëllim, ai njoftoi se, të gjithë nëpunësit do t'i nënshtroheshin një kontrolli nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit.

Në një korenspondencë, me gjyqin e sheriatit, të Tiranës, Haxhi Vebi Dibra, do të këmbëngulte dhe theksonte: "Ngjitet u kthehet shkresa nr. 37, 21 shkurt 1922, dërguar Gjyqit të Naltë të Sheriatit për shkak se është shkruar në turqisht. Meqenëse korenspondenca duhet ba në shqipen zyrtare, jeni të porositur për të dytën herë që të mos i dërgoni këtij gjyqi shkresa të shkrueme në gjuhën turke, se nuk do të kryhet asnjë formalitet mbi to". Një rëndësi e veçantë, në këtë periudhë, iu kushtua edhe përdorimit të simbolikës kombëtare. Haxhi Vebi Dibra, në mars të vitit 1921, porosishte gjyqin e sherisë së Vlorës që të shkresat dhe aktet zyrtare të mos përdorte vulat turke, por të merrte sa më shpejt që të ishte e mundur një vulë me shqiponjë.

Në një telegram, datë 23 dhjetor 1922, që Haxhi Vebi Dibra i dërgonte Abdylmexhidi II-të, në zgjedhjen e tij si Kalif i



Opinion i Ditës

# 10 mëkatet kapitale të ekonomisë shqiptare

Nga Dr. Klodian Muço

(vijon nga faqja 1)

...kompleks. Rritja ekonomike përgjatë tranzicionit nuk shërben si një bazë stabil për të gënjatur zhvillim të qëndrueshëm në kohë. Instabiliteti ekonomik që pengon zhvillimin në kompleks derivon mbi të gjitha nga 10 gabimet e rënda që ekonomia jonë vazhdon të mos i korrigjojë ndër vite: evazioni fiskal, mungesa e konkurrencës dhe pabarazia, korrupsioni, problemet e pronësisë, rënia e vazhdueshme e demografisë, largimi i studentëve dhe të diplomuarve ekselentë, e drejta e zgjedhjes, paaftësia e administratës publike, keqmenaxhimi i pronave publike si dhe burokracia.

Evazioni fiskal është një "sëmundje" shumë e përhapur, e cila asnjëherë nuk është ridimensionuar nga reformat e ndryshme. Një ndër raportet e fundit të Bankës Botërore evidenton se rreth 30% e bizneseve operon në informalitet, rreth 47% e TVSH-së nuk mbledhet e në disa taksa sipas tyre evazioni varion nga 50%-100%. Një reformë e aftë, e cila do të bënte të mundur rekuperimin e kësaj shume, do të ndihmonte vendin të dilte nga kjo "stinë" e pasigurisë dhe do të bënte të mundur reduktimin e ndjeshëm të barrës fiskale aktuale. Sipas disa përlogaritjeve rreth 4/5 e pasurisë së fshehur në parajsat fiskale i përkasin vetëm 0.013% të popullsisë. Pra, janë të pasurit ata që bëjnë evazion fiskal. Janë ata që stimulojnë pabarazinë dhe përfitojnë nga mungesa e konkurrencës. Janë këta që influencojnë politikëbërësit të devijojnë rritjen ekonomike të vendit në favor të pasurimit të tyre.

Përgjatë viteve të fundit pabarazia e të ardhurave po rritet gjithmonë e më tepër, treguesi i Ginit është përqendruar me 7 pikë. Sipërmarrësit paguajnë gjithmonë e më pak në raport me fitimet e tyre ndërsa shumicës së qytetarëve u rritet kosto e jetesës dhe u ngelen gjithmonë e më pak para për konsum.

Një faktor tjetër që ka stimuluar pabarazinë dhe varfërinë është ai i korrupsionit, i cili pengon rritjen ekonomike, rrit kostot e investimeve dhe redukton cilësinë e



tyre. Shpesh punonjësit e administratës publike të korruptuar kanë tendencën të korruptojnë edhe vartësit e tyre. Gjë kjo që sjell një përqendrim të cilësive së kapitalit institucional, ky i fundit është faktor përcaktues i performancës ekonomike të vendeve. Pa nënvlerësuar rëndësinë e faktorëve socio-kulturor, është më se i verifikueshëm fakti se aseti institucional është faktor primar i cilësisë dhe intensitetit të procesit të zhvillimit në një vend të caktuar. Pasi janë institucionet ekonomike ato që garantojnë të drejtën e pronësisë pa të cilën një ekonomi tregu nuk do të mund të ekzistojë. Kjo e fundit nënkupton faktin që konsumatori në mënyrë demokratike në bazë të buxhetit që disponon ka të drejtë për të zgjedhur produktin më të mirë të mundshëm në treg.

Nobelisti në ekonomi për '98-ën, Amartya Sen thotë se zhvillimi në vetvete është liria e zgjedhjes. Ne sot nuk zgjedhim dot, sepse demokracia jonë nuk është votuese-konkurrese, që ka si karakteristikë zgjedhjen e një elite të aftë. Ne sot votojmë për partinë dhe për shumë të paafte që mbushin listat e tyre pa asnjë kriter. Demokracia e vërtetë duhet të pengonte në momente të caktuara pushtetin për të evituar abuzimet, duhet të orientojë politikën ekonomike.

Baza e çdo demokracie është menaxhimi i tregut nga ndërmarrësit dhe qeveria si mbikëqyrëse përcakton dhe monitoron rregullat e lojës pa mbajtur në asnjë moment anën e ndonjë ndërmarrje. Gjë që në Shqipëri ndodh krejt e kundërta. Te ne vazhdohet akoma të mendohet se zhvillimi ekonomik

i vendit do të vij nga të huajt.

Zhvillimi duhet të vijë nga brenda, si ka mundësi që te ne vazhdojnë akoma drejtues të rëndësishëm apo me dhjetëra deputetë kanë një diplomë nga universiteti i 'Krishtalit'.

Jemi një vend ku mbretëron paaftësia, e cila vret shpresën. Moshë mesatare në Shqipëri përgjatë 25 viteve të fundit ka kaluar nga 21.4 në 35 vjeç. Nëse nuk do ndryshoj diçka shumë shpejt do të jemi një vend pleqsh, ku moshë për të dalë në pension do shkojë mbi 70 vjeç e të rinjtë gjithmonë e më tepër s'do gjejnë më veten në këtë vend e do largohen jashtë Shqipërisë.

Vitin e kaluar 24% e maturantëve zgjidhën të studiojnë jashtë, pjesa dërmuese e tyre nuk kthehen më në atdhe. Kjo nuk është një retorikë; është emergjencë

për Shqipërinë. Ky nuk është problem i vogël, është një shkatërrim, truri po ikën.

Nëse nuk vendoset një sistem i qartë për të matur talentin, asnjë nuk ka më stimuj të bëhet.

Sipas militantëve partiakë nuk është e rëndësishme të studiosh pasi puna mësohet në praktikë. Kjo do të thotë që nëse të studiosh është e pa nevojshme, nuk ka më sens të shpenzohet në arsimim. Kjo gjë lë një pyetje pa përgjigje: si do të zhvillohet ekonomia në vendin tonë?

Nëse një vend që aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Europian, lëndët e para ua jep të huajve t'i shfrytëzojnë pa bërë investime, ka mungesë të theksuar të kapitalit financiar. Këtyri vend hiqje dhe kapitalin human, jo edhe nëpër bordet e universiteteve publike ca militant partish që termat kërkim shkencor apo fonde për kërkim shkencor u shkaktojnë buzëqeshje pa fund. Si drejtin mund të kemi një rritje ekonomike të qëndrueshme në?

Nga ana tjetër kemi një burokraci të ekzagjeruar, e cila e shoqëruar edhe me presionin fiskal të lartë, pengon investitorët e huaj dhe e bën të vështirë hapjen e vendeve të reja të punës.

Të korrigjosh të gjitha këto gabime në fakt nuk është e pa mundur. Evazioni fiskal të dënohet penalisht.

Të kalohet në një sistem fiskal flat tax 8% duke çuar evazionin fiskal drejt zeros bëhesh vendi me sistemin fiskal më kompetitiv në Europë dhe nuk rrënon financat publike.

Të ndryshohet sistemi zgjedhor për të votuar për individin dhe jo për partinë.

Të aplikohen konkurset e pikëzuara dhe transparente ku mesatarja në shkollë e lartë të jetë determinante në zgjedhje për pozicionet drejtuese.

Kush shpërdoron paratë publike ti paguaj nga xhepat e tij, si ai që heq njerëz nga puna në mënyrë të pa drejtë po ashtu edhe ai që përcakton çmimet e rrugëve të njëjta me shtetet më të pasura të Europës duke harruar se ne jemi vendi më rrogat më të ulta.

**BLUE TOOTH**

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta

**Vipave**

çdo të shtunë falas me

Opinion i Ditës

Pedagogjia narrative dhe formimi shkencor - nga historia te fakti

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

...të shkencës nga të gjithë. Hulumtimet, gjatë 20 viteve të fundit, ndoshta dhe më shumë, tregojnë se programet e edukimit shkencor, në shumë vende (përfshirë ne), nuk janë të suksesshme në arritjen e secilit synim. Numri i nxënësve që studiojnë shkencën në nivel universitar po zvogëlohet. Shkenca - si zhvillohet në shkolla - nuk është tërheqëse për pjesën më të madhe të nxënësve. Mënyra me të cilën ajo shtjellohet, zakonisht, paraqet vetëm rezultatet, në vend që të qartësojë procesin. Për shumë arsye, kjo është sfidë, ndaj, edukimi shkencor është fushë kërkimi në rritje. Pjesë e saj është roli i pedagogjisë narrative në edukimin shkencor të nxënësve.

Mjaft studiues dhe mësues të shkencave kanë mbështetur përdorimin e historive shkencore për nxënien në shkollë (P. Leipzig, 2018; I. Goodson, 2011; Barker, 2004; Solomon, 2002; Gilbert, 2001). Pohohet se "historitë mund të ilustrjnë ose të ofrojnë 'një sfond' për konceptet shkencore që mësohen"; se "historitë janë mënyrë për të shtuar 'interestin njerëzor' ndaj shkencës, duke e bërë më interesante"; se "historitë janë mënyrë për t'i 'përfshirë' nxënësit që e shohin shkencën të paarrtshme dhe të huaj".

Të gjithë mund të mendojmë rreth një historie. Njerëzit familjarizohen me një histori, kur e dëgjojnë ose e shohin atë. Aftësia për të kuptuar, përdorur dhe vlerësuar një histori është e nënkuptuar, kulturore. Ajo mbështetet në njohjen e thellë të njerëzve - në ndjenjat, shqetësimet dhe marrëdhëniet e tyre me të tjerët, me gjasë, në kontekste të caktuara. Ndërkaq, për shumicën, shkenca është lëndë e vështirë. Mësimi i saj, tradicionalisht, ka synuar aftësimin e subjekteve për të menduar 'shkencërisht'. Ky lloj të menduarit, shpesh, është sfidues në aspektin njohës; ndërkohë, ka dhe një arsye tjetër, më themelore. Mendimi shkencor nuk 'rrjedh natyrshëm' për shumicën e njerëzve. Ai ndryshon nga format e zakonshme, 'të përditshme' të menduarit. Sepse është abstrakt, jo rrallë kundër intuitës, i panjohur dhe, nga pikëpamja e përvajave dhe interesave të përditshme, shpesh, mjaft i huaj.

Profesori Jerome Bruner - një nga arkitektët kryesorë të revolucionit kognitiv - e ka hulumtuar idenë në librin e tij "Mendjet aktuale, botët e mundshme". Ai identifikoi dy mënyra të dallueshme, se si realizohet procesi njohës. Ato plotësojnë njëra-tjetrën, mirëpo, janë tejet të ndryshme sa i takon mënyrë se si e orientojnë përvojën dhe ndërtojnë realitetin. Të dyja janë të nevojshme për të kuptuar atë që ai e quan 'larmi e pasur e mendimit'. Bruner, njerën nga këto mënyra, e quan mënyra 'logjiko-shkencore', tjetrën mënyra 'tregimtare' ('narrative mode'). Nëpërmjet të parës kuptohet bota duke abstraktuar veten nga jeta e përditshme, duke u veguar nga ndjenjat dhe interesat subjektive. Qëllimi i saj janë provat formale / logjike ose teoritë që shpjegojnë si funksionon bota natyrore. Në anën tjetër, edhe mënyra 'tregimtare' synon t'i japë kuptim botës, por e bën ndryshe këtë. Njerëzit, në vend që ta përjashtojnë njëri-tjetrin, bashkohen. Veprimet, motivet dhe marrëdhëniet e tyre strukturohen dhe shpjegohen përmes historive. Në të gjitha kulturat, për të gjithë, këto janë të rëndësishme dhe të gjithë e kuptojnë se si mendojnë rreth historive.

Psikologët pohojnë se është me vlerë për zhvillimin e fëmijëve që atyre t'u tregohen histori. Sikundër, fëmijët të jenë në gjendje të tregojnë histori për veten, por dhe të dëgjojnë e vlerësojnë nga njerëz të afërt e të rëndësishëm për ta. Historitë janë "mjet i rëndësishëm përmes të cilit njerëzit angazhohen me njëri-tjetrin; së pari, me ata që kanë pranë dhe, më vonë, me anëtarët e tjerë të kulturës / kombit dhe sistemet e dijeve të asaj culture / kombi" (Campbell, 1997). Historitë, gjithashtu, "janë tejet të rëndësishme për edukimin e ndjenjës së identitetit të individit, ato krijojnë kontekstin ku ai zhvillon ndjenjën se çfarë mund të jetë vendi i tij në botë" (Connelly & Clandinin, 2000; Miller, 1995). Historitë zhvillojnë aftësinë e individëve për të imagjinuar dhe krijuar; aftësinë për të imagjinuar botët që dallojnë nga e tyreja, si dhe aftësinë për ta imagjinuar veten duke bërë gjëra që janë të ndryshme nga realiteti i tyre. "Për sh-



tuar atë që ai e quan 'larmi e pasur e mendimit'. Bruner, njerën nga këto mënyra, e quan mënyra 'logjiko-shkencore', tjetrën mënyra 'tregimtare' ('narrative mode'). Nëpërmjet të parës kuptohet bota duke abstraktuar veten nga jeta e përditshme, duke u veguar nga ndjenjat dhe interesat subjektive. Qëllimi i saj janë provat formale / logjike ose teoritë që shpjegojnë si funksionon bota natyrore. Në anën tjetër, edhe mënyra 'tregimtare' synon t'i japë kuptim botës, por e bën ndryshe këtë. Njerëzit, në vend që ta përjashtojnë njëri-tjetrin, bashkohen. Veprimet, motivet dhe marrëdhëniet e tyre strukturohen dhe shpjegohen përmes historive. Në të gjitha kulturat, për të gjithë, këto janë të rëndësishme dhe të gjithë e kuptojnë se si mendojnë rreth historive.

Psikologët pohojnë se është me vlerë për zhvillimin e fëmijëve që atyre t'u tregohen histori. Sikundër, fëmijët të jenë në gjendje të tregojnë histori për veten, por dhe të dëgjojnë e vlerësojnë nga njerëz të afërt e të rëndësishëm për ta. Historitë janë "mjet i rëndësishëm përmes të cilit njerëzit angazhohen me njëri-tjetrin; së pari, me ata që kanë pranë dhe, më vonë, me anëtarët e tjerë të kulturës / kombit dhe sistemet e dijeve të asaj culture / kombi" (Campbell, 1997). Historitë, gjithashtu, "janë tejet të rëndësishme për edukimin e ndjenjës së identitetit të individit, ato krijojnë kontekstin ku ai zhvillon ndjenjën se çfarë mund të jetë vendi i tij në botë" (Connelly & Clandinin, 2000; Miller, 1995). Historitë zhvillojnë aftësinë e individëve për të imagjinuar dhe krijuar; aftësinë për të imagjinuar botët që dallojnë nga e tyreja, si dhe aftësinë për ta imagjinuar veten duke bërë gjëra që janë të ndryshme nga realiteti i tyre. "Për sh-

kak se historitë janë format i njohur, një e tillë mund të rritë nivelin e komoditetit me materialin e panjohur" (Prins, Avraamidou & Goedhart, 2017). Historitë nuk pasqyrojnë thjesht 'realitetin' e një personi: ato lozin rol aktiv në edukimin e tij. Për këto arsye, historitë ndikojnë fort edukimin në vitet e hershme. Ndërkaq, ka argumente interesante për përdorimin e historive, edhe përtej viteve të hershme dhe në kontekste (si shkenca) ku ato, zakonisht, nuk janë konsideruar të përshtatshme.

Për përdorimin e historive shkencore në edukimin shkencor ka mjaft argumente. I pari, në thelb, është njohës. Nëse të gjithë e kuptojnë se si mendojnë rreth historive, atëherë pse të mos e përdorim historinë si format të njohur, si mjet për mënyra të tjera të menduarit? Nëse - siç argumenton Bruner - mënyra 'tregimtare' dhe ajo 'logjiko-shkencore' dallojnë dhe nuk mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën dhe, nëse njëra zhvillohen përpara tjetrës, atëherë pse të mos e përdorim të parën si urë lidhëse me të dytën? Nxënien e shkencës në shkollë nuk duhet të përfshijë mendimin 'shkencor'; të paktën, jo në fazat e hershme të zhvillimit. Mençuria këtë kërkon, megjithatë, në procesin e edukimit, nuk e dallojmë qartë kalimin nga mënyra tregimtare në të menduarin shkencor. Shumica e nxënësve nuk e kuptojnë asnjë herë këtë dallim dhe, si rezultat, e gjejnë shkencën "të vështirë". Mirëpo, nëse ata mund ta mësojnë shkencën, së paku, fillimisht, duke përdorur një mënyrë të menduarit që e kuptojnë (edhe pse shkenca që nxënë nuk është shkencë 'e vërtetë'), atëherë, ndoshta, më shumë nxënës mund të angazhohen në nxënien.

Pasi krijohet themeli i njohur

rive bazë, kalimi nga mënyra tregimtare në atë shkencore, mund të menaxhohet më saktë dhe me matur. Sigurisht, jetësimi i një qasje të tillë e dallon qartë edukimin shkencor nga vetë shkenca. Mirëpo, shkenca, në shkollë, e paraqitur si 'fakt', si dije përfundimtare e panegociueshme, nuk e bën atë të lehtë. Rezultati: për shumicën e njerëzve, shkenca është diçka që u dashka studiuar, paçka se në të ardhmen ata dëshirojnë të bëjnë diçka tjetër. Dhe ata nxënë, ose në mënyrë pasive sipas rregullave të vendosura nga të tjerët, si spektatorë me të vërtetë të papërfshirë, ose si diçka që duhet shmangur, sa më shpejt që është e mundur. Ndërkaq, edhe pse pikëpamja për mënyrën se si shtjellohen dijet shkencore në shkolla është kontestuar nga shumë filozofë të njohjes, psikologë dhe sociologë, kjo mënyrë mbetet baze e shumicës së programeve të edukimit shkencor.

Nisur këndej, pedagogët e narracionit besojnë se përdorimi i historive shkencore, përtej viteve të fëmijërisë së hershme - të paktën në teori - është ide e mirë për ta mësuar shkencën në shkollë. Sikundër besohet që ideja ka pika të forta të dukshme dhe disa kufizime po aq të dukshme. Ne mendojmë se duhet të pranohet kufizimet e idesë dhe të përiqemi të përdorim pikat e forta. Si qasje e dobishme për t'u dhënë nxënësve orientimin e duhur për t'u përbalhur me sidat e shoqërive të dijes.

Një nga pikat e forta të përdorimit të historive shkencore është se ato mund të përdoren si urë që lidh të menduarit 'tregimtar' me atë 'logjiko-shkencor'. Megjithatë, të jemi të qartë: shkenca 'e vërtetë' nuk është histori. Kuptimi i shkencës duhet të përfshijë kuptimin si mendojnë shkencëtarët. Mirëpo, nuk është e nevojshme ta bëjmë këtë që në fillim. Ne mund të përdorim historitë shkencore për të mësuar shkencën në arsimin fillor; por jo në shkollën e mesme. Tranzicioni nga historia shkencore në të menduarit 'logjik-shkencor' duhet të jetë 'mbështetje' - përdryshe, për shumicën e nxënësve, ku tranzicioni vështirë se mund të ndodhë. Historitë shkencore janë mënyrë e mirë për këtë. Është një udhëtim i gjatë ky, i ngadalshëm, nga një lloj i të menduarit, të tjetri. Ka pengesa dhe ndalesa gjatë rrugës. Duke i parë historitë si mënyrë për të kapërcyer disa përjetë pengesave, lejohejmë të përdorim pikat e forta të tyre, duke pranuar njëherazi kufizimet e tyre.

Nëse pedagogjia narrative vlen, si mund jetësohet ajo në praktikë shkollë? Cilat janë vlerat? Po kurthet? A i afron ajo nxënësit me shkencën? Nëse zhvillojmë disa histori të mira me tema shkencore, a do mund të mësojnë nxënësit prej tyre? Pyetje këto që, ndoshta, nxitin psikologët, pedagogët dhe filozofët tanë për më tej.

Horoskopi section containing 12 daily horoscope entries (DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, UJORI, PESHQIT) with short astrological advice for each sign.

**Serie A luan sfidat e së dieles, fiton dhe Atalanta e Berishës dhe Gjimshirit**

**Interi fiton për ditëlindje dhe i lëshon sfidën Milanit në prag të derbit**

Interi rikthehet te fitorja, pasi mposhti Spalin me rezultatin 2-0, duke marrë një 3-pikësh mjaft të rëndësishëm, vetëm një javë para ndeshjes derbi me Milanin, e programuar për të dielën e ardhshme. Zikaltrit e nisën mirë takimin dhe arritën të shënojnë me anë të sulmuesit Lautaro Martinez, por ndërhyrja e VAR-i bëri të pavlefshëm golin, pasi vërehej një prekje me dorë në momentin e marrjes së topit nga argjentinas. Më

pas gjithçka filloi të shkojë keq për zikaltrit, që fillimisht panë t'u dëmtuara Brozović dhe më vonë mbrojtësi brazilian Miranda, ndërsa me dy zëvendësime të detyruara, Spalati nuk po arrinte t'i japë orientimin e duhur skuadrës. Goli i zhbllokimit të rezultatit erdhi në minutën e 67, kur Mateo Politano u shërbye mirë në zonë dhe me një veprim të shpejtë, gjuajti, ndërsa falë edhe një devijimi, topi u ndal në rrjetën e portierit të Spalit, Emiliano Viviano. Vetëm 10 minuta më vonë, pas një aksio-

ni të gjatë të zikaltrëve, ishte mesfushori italian Roberto Galjardini, që pasi u shërbye në zonë nga Sedrik Soares, arriti të gjuajë saktë dhe të shënojë golin e dytë, që qetësoi skuadrën. Më pas zikaltrit menaxhuan mirë lojën, duke krijuar edhe 2-3 mundësi të

tjera shënimi, ndërsa në fund mbeti në fuqi rezultati 2-0, që çoi Interin në kuotën e 50 pikëve në vendin e katërt, me vetëm një pikë më pak se Milani, në prag të derbit të Madoninës. Një fitore mjaft të rëndësishme mori edhe Atalanta, në transfertën gjenoveze

përballë Sampdorias, ku triumfoi me rezultatin 1-2. Duван Zapata dhe Gosens shënuan për zikaltrit, ndërsa dorianët barazuan përkohësisht me Fabio Kuajliarelën. Ky i fundit shënoi sot golin e tij të 20 në kampionatin italian, duke parakaluar Kristiano Ronaldo

dhe Piatek dhe duke kryesuar i vetëm renditjen e golshënuesve. Natyrisht që këto janë shifra mahnitëse, për më tepër kur mendojmë se kemi të bëjmë me një sulmues 36-vjeçar, që po përjeton një rini të dytë. Fitore mori edhe Torino, që mposhti 1-2 Frosinonen në transfertë. Vendasit kaluan të parët në avantazh, me një gol të shënuar në pjesën e parë, ndërsa Torino shënoi dy herë në 45-minutëshin e dytë, me anë të kapitenit Beloti, duke marrë 3 pikët.

Anësori i Sionit ka mbetur vërtet i habitur nga mosgrumbullimi i tij për ndeshjet ndaj Turqisë dhe Andorrës

**Angli, tifozi godet me grusht kapitenin kundërshtar**

Një ngjarje antisportive ka ndodhur ditën e djeshme në Angli, saktësisht në Championship. 10 minuta nga fillimi i ndeshjes mes Birminghamit dhe Aston Vilës, një tifoz i vendasve ka arritur të depërtojë në fushë duke goditur me grusht kapitenin e miqve, Grejlish, i cili nga goditja e marrë u rrëzua në tokë. Kapiteni i Aston Vilës ishte me shpinë nga agresori dhe nuk e vuri re në momentin e parë duke u kapur i papërgatitur nga gjesti i shëmtuar i tifozit. Në këtë situatë menjëherë ndërhyri një shtuart, i cili neutralizoi agresorin, që më pas u përcoll i shoqëruar jashtë stadiumit, ndërsa me siguri ndaj tij do të merren masa të rrepta ndëshkimore. Megjithatë, për tu rikthyer te ndeshja, grushti i tifozit nuk ndikoi fare në lojën e futbollistit të Aston Vilës, i cili vazhdoi rregullisht ndeshjen madje duke u bërë dhe protagonist i saj. Në minutën e 67, Grejlish realizoi golin e fitores për të tiftë, duke u hakmarrë kështu në një farë forme ndaj gjestit antisportiv të tifozit kundërshtar.



Jeton Selimi

**Mbrojtësi habitet nga vendimi, Lenjani: Panuçi s'më ka thirrur!**

*29-vjeçari reagon në profilin e tij në 'Instagram'*

Ermir Lenjani do të jetë një nga mungesat e mëdha të Shqipërisë në listën e futbollistëve të grumbulluar për dy ndeshjet e muajit mars ndaj Turqisë dhe Andorrës. Edhe pse po paraqitet shumë mirë me Sionin në këtë sezon, madje është duke zhvilluar një nga kampionatet e tij më të mira, anësori 29-vjeçar nuk do të jetë në listën që Kristian Panuçi do të shpallë të enjten e ardhshme dhe lajmin e ka zyrtarizuar vetë Lenjani, i cili nuk ka marrë ftesë për 2 ndeshjet e radhës të Kombëtares kuqezi edhe pse mund të ishte një alternativë shumë e mirë si në krahët e sulmit ashtu edhe në ato të mbrojtjes duke parë problemet që po hasin kuqezinjët në këto pozicione.

Me anë të një reagimi në faqen e tij zyrtare në 'Instagram', Lenjani ka shkruar në "story", se: "Çuditërisht nuk jam ftuar për ndeshjet e muajit mars nga Kombëtarja"-thotë në reagimin e tij mbrojtësi. Në



fakt, nuk është hera e parë që Panuçi vepron në këtë mënyrë, duke kujtuar këtu se ka pasur shumë raste të

tjera që trajneri i Kombëtares ka lënë jashtë grumbullimit futbollist shumë cilësor. Ky sezon

është një nga më të mirët për mbrojtësin anësor të kombëtares, që më shumë se sa në pozicionin e tij

natyral, ka luajtur si mesfushor i avancuar te Sion. Kështu Lenjani ka gjetur tre herë rrjetën në kampionat, ndërsa ka asistuar në total 7 gola, 4 prej tyre në kampionat dhe 3 në Kupën e Zvicrës. Duke pasur parasysh faktin se kombëtarja do të ketë mungesa në krahët e sulmit, Lenjani mund të ishte një alternativë e mirë për trajnerin, por ja që Panuçi ka vendosur të mos i dërgojë një ftesë. Arsyet pritet t'i zbulojë trajneri në ditët në vijim.

Ndërkohë, pas reagimit të parë, Lenjani ka bërë një tjetër reagim, duke postuar një tjetër stori ku ka disa pikëpyetje, që lë të kuptohet se kërkon sqarim për mungesën e ftesës nga Panuçi.

**SULMUESI I PSG-SË**

**Mbape: Nuk më zinte gjumi nga eliminimi**

Kilian Mbape ka pranuar se eliminimi nga Liga e Kampioneve me PSG ka qenë një nga momentet më të vështira të karrierës së tij futbollistike. Sulmuesi francez i parisienëve ishte ndër më të zhgënjyerit pas disfatës ndaj Manchester Junajtid dhe shumëkush mendonte se ajo do ta shtynte drejt largimit, me Real Madrid të gatshëm të bënte çmenduri për të siguruar firmën e tij. Por duket se lojtarit është lidhur edhe më shumë me klubin pas kësaj disfatë, duke dëshur të triumfojë meoemos me të. "Pas asaj që ndodhi, vazhdoj të besoj në këtë pro-



jekt dhe jam i sigurt që do të bëjmë diçka të mirë për këtë klub. E ardhmja? Do të mbetem i lidhur me këtë klub, kjo është e sigurt", tha Mbape, i cili ka treguar edhe sa keq e ka përjetuar daljen nga Europa, por duke e cilësuar të merituar. "Isha i tronditur, mbeta pa fjalë, nuk

mund të flija. Stadiumi ishte i mbushur, tifozët bënë punën e tyre dhe na mbështetën, ambienti ishte i shkëlqyer. Ne deshmë që t'ia dilnim por në fund shkatërruam gjithçka. Nëse u eliminuam, ndodhi sepse ndoshta nuk ishim në lartësinë e duhur", pranoi ai.

**Ndodh në Serie B të Italisë**


**Humbasin derbin, tifozët u vënë bomba drejtuesve dhe lojtarëve**



makina e sulmuesit të Foxhias, Pietro Iemelo. Pasoja dhe kërcënim më serioz ka pasur mesfushori Masimo Buselato, i cili pak minuta para fundit të takimit, është ndëshkuar me karton të kuq. Agresorët kanë sulmuar me

bombë shtëpinë e futbollistit, por fatmirësisht nuk është lënduar. Ai ka bërë denoncimin në polici dhe tashmë janë karabinierët, të cilët po merren me hetimin dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes.

### Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Një pikturë vetes.
  - Lindgren e Pippi çorapëgjatës.
  - Thirrje edhe kështu Persefoni.
  - Hapin ekspozitën.
  - Ruhet pa çifte.
  - Shiroka aktor.
  - Fillojnë masat.
  - Të parat në aksion.
  - Eshtë gara më e gjatë.
  - Inicialet Pacino-s.
  - Janë sponsor të Tiranës.
  - Pavone këngëtare.
  - Kështu thirrje Marco Pantani.
  - Dieta pa ekstreme.
  - Janë salla për projeksione.
  - Duhet çarë në dritë.
  - Italia në tabela.
  - Janë katrorë në sipërfaqe.
  - Williams tenisiste.
  - Në fillim të verës.
  - Cocker këngëtar.


- Të fundit në tender.
  - Janë fletë trëndafili.
  - Fillojnë ideologjinë.
  - Eshtë krahinë e Athinës.
  - Emri i Zola.
  - Hari spiune.
  - Janë kulla në xhami.
- VERTIKAL**
- Njësi matëse për kondensator.
  - Artet pa re.
  - Fillojnë uraganin.
  - Nisin titrimin.
  - Janë në modë.
  - Inicialet e Kokoschka-s.
  - Një mund të jetë ekspres.
  - Mund të jenë ushtarake.
  - Jepen për hartim.
  - Janë të lira për hartim.
  - Eshtë magjik ai i fatave.
  - Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
  - Një organizatë humanitare.
  - Janë shkurre.
  - Janë kapo kozakë.
  - Nino kompozitor.
  - Fillojnë teorinë.
  - Kryqyteti i asirëve.
  - Një verë në Paris.
  - Një vepër si romani.
  - Mbyllin një sherr.
  - Kompozoi një Bolero.
  - Pak mbeturina.
  - Një bëhet për të mirë.
  - Eshtë dhomë.
  - Peter që humb hijen.
  - Një pjesë e territorit.
  - Pak amerikanë.
  - Gjysmë litari.
  - Dy asa.
  - Kalimi në kutij.

### Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- Mondrian piktur.
  - Safin tenist.
  - Eshtë e re pas Krishtit.
  - Janë grimca të famjës së adroneve të tilla.
  - Fillojnë matematikën.
  - Mbarojnë fare.
  - Josa trainer.
  - Në mes të dhomës.
  - Gjysma e inatit.
  - Ishin shkolla edukimi.
  - Janë ritransmetues televizivë.
  - Ishtë djali që vrau Odiseun.
  - Një pjesë e opozitës.
  - Një ekspres në binarë.
  - Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
  - Mund të lakohen.
  - Një yll me bisht.
  - Italia në Internet.

- Edouard piktur.
- Shahu i fundit.
- Gjysma e aortës.
- Efekt... i François Truffaut.
- Inicialet e Lendl.
- Kufizojnë një kënd.
- Polanski regjisor.
- Skuadër greke.
- Britma e Arkimedit.
- Egogyan regjisor.
- Fillojnë turin.


- VERTIKAL**
- Ishtë shkolla e Arkimedit.
  - Grandi këngëtare.
  - Diftong teatral.
  - I përkasin stinës së nxehtë.
  - Një shishe bombë.
  - Janë në qendër.
  - Ndiqet nga një mi.
  - Janë këngëtarë lirikë.
  - Emër burri.
  - Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
  - Botom pa ekstreme.
  - Eshtë figurë letrare.
  - Eshtë enë kryesore gjaku.
  - Një pikë në ligj.
  - Risja pa kufij.
  - Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
  - Janë fletë trëndafili.
  - Robert Mitchum.
  - Inicialet e Moravia-s.
  - Eshtë si fatë.
  - Gjysma e ketrit.
  - Carolina e belle epoques.
  - U shkrua nga Zola.
  - Me të bëhet trokë.
  - Duken të parat.
  - Maten të parat.
  - Të parat në kufij.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

E	R	A	S	M	I	P	A	K	E	T	A	T
L	O	R	I	S	K	U	M	A	R	I	O	
U	N	I	K	S	A	N	F	S	E	G		
A	A	M	E	S	I	M	O	R	E	S		
R	B	M	E	R	E	M	E	T	I	M	E	T
D	E	L	I	K	A	T	E	T	V	L	A	
S	A	R	A	F	E	T	R	A	C	E	R	
P	T	R	A	T	I	M	O	L	I	N	E	
M	I	G	E	N	A	R	E	N	A	T		
B	E	S	E	E	T	E	R	T	I			
A	T	A	E	T	A	S	A	K	R	A		
N		A	R	K	R	I	T	E	M	A		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

### SUDOK

5		1	4					
4	9							3
	6			5				
			9			8		
						6		
		4	6	5		2	1	
2	3	6				1		
				2		4		
								5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	3	1	9	7	4	6	8	2
4	2	7	1	8	6	9	5	3
8	9	6	2	5	3	4	7	1
3	7	4	6	9	2	5	1	8
1	8	5	3	4	7	2	6	9
2	6	9	5	1	8	3	4	7
6	1	8	4	2	9	7	3	5
7	4	2	8	3	5	1	9	6
9	5	3	7	6	1	8	2	4

### Argëtim filozofik

- Jeta nuk ju jep kurrë siguri ... ju jep vetëm mundësi !!!
- Eshtë mungesa e shpresës që e thyen shpirtin tonë, më shumë se dhimbja.
- "Fal"... sepse një ditë ju do të keni nevojë për një falje !!!
- Mos trokit në derën e dikujt që e hap atë për të gjithë ... sepse miku i të gjithëve nuk është miku i askujt !!!
- Ai që tradhton besimin tim, nuk vlen as respektin tim !!!
- Dikur isha i gatshëm t'i fal gabimet e të tjerëve...Derisa konstatova se të tjerët ishin gjithmonë të gatshëm t'i përsërisin.

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	2	9	4	1	10	5	10													
F	7	8	6		15	3	6	10	3											
10	2	8	5	3	9	3	7		9											
5	K	1	2	3	11	3	4	7	5	8	4									
1	A	2	8	11	1	12	8	11	3	13	8									
5	3	6	3	12	8	13	8			1	6									
1		7	4	3	13	7	3		6											
2	3	8		7	5	1	11	3	4											
7	6	4	1	4	3	13	7	4	3	6										
11	3	2		16	8	11	9	15	4											
7	4	8	6	8	8	16		8	3	10										

F	T	F	S	T	O	P	K	P			
F	I	E	R	H	A	R	P	A			
O	F	E	K	A	S	A	I	S			
K	O	F	A	N	A	T	I	K	E	T	
A	K	F	E	N	O	M	E	N	A	L	E
K	A	R	A	M	E	L	E	I	R		
K	N	A	D	A	R	R	R	O			
O	I	T	A	L	I	A	R	R			
F	A	E	I	K	O	N	A	T			
I	R	T	O	T	A	L	I	T	A	R	
N	A	F	D	E	N	S	H	T			
I	T	E	R	E	E	D	E	A	P		

### Thënie të mençura

- Thonë se të gjithë njerëzit janë si hëna, kanë një anë të cilën kurrë nuk ia tregojnë askujt !!!
- Nuk kam asnjë problem me ata që nuk dinë se çfarë kërkojnë. Mjafton të mos kërkojnë në jetën time.
- Gabimi më i madh në jetë është të lejosh disa njerëz të qëndrojnë në jetën tuaj më shumë se sa e meritojnë!!!
- E vërteta nuk është e sigurt se mund të na çlirojë, por ndershmëria mundet.
- Të dashurosh dikë që nuk të do, është sikur të presësh një anije në aeroport.

